



Buletini i Shkencave Gjeologjike

1/2024

Buletin of Geological Sciences

BORDI EDITORIAL

DR. SOKOL MARKU - KRYEREDAKTOR
DR. MADALINA ELENA KALLANXHI - SEKRETAR
PROF. ASS. DR. VEIP GJONI - ANËTAR
DR. ALTIN KARRIQI - ANËTAR
PROF. DR. IRAKLI PRIFTI - ANËTAR
PROF. DR. KUJTIM ONUZI - ANËTAR
DR. ANDREEA UTA - ANËTAR

ING. ELISA PRENDI - REDAKTORE PËRGJEGJËSE

ISSN 0254-5276

Mikrofosilet dhe mikrofaciet te depozitimeve karbonatike me moshe Aptian i poshtem (Bedoulian) nga Myçhasi (Hasi), zona gjeologjike Mirdita

[Microfossils and microfacies from the lower Aptian (Bedoulian) carbonate deposits of Myçhasi (Hasi), Mirdita zone]

Andreea Uta, Bardhyl Muceku 3 [21]

Mineralizime hidrotermale – teletermale në rajonin e dibrës dhe probleme të perspektivës së kërkimeve

[Hydrothermal – telethermal mineralizations in dibra region and their exploration perspective]

Vesel Hoxha, Ilir Alliu 39 [61]

Potenciali mineralmbajtës në shkëmbjintë magmatikë të zonës Moravë – Mali i Kuq

[Mineral bearing potential of the magmatic rocks from the Morava - Mali i Kuq area]

Panajot Aliçkolli, Kozeta Nasto, Zhuljeta Misho, Mădălina – Elena Kallanxhi, Maga Ceroni 83 [99]

Vështrim i përgjithshëm mbi depozitimet deltaike të lumit Shkumbin

[An overview of the Shkumbin river deltaic deposits]

Majlinda Meçaj (Sina) 115 [125]

Vlerësimi dhe analizimi i të dhënave litologjike, për qëllime të ndërtimit të Hartës Gjeoteknike të Shqipërisë në shkallë 1:200 000

[Lithological data estimation and analysis, in support to the Geotechnical Map of Albania (scale 1:200 000)]

Mentor Lamaj, Ylber Muceku, Albert Avxhi 135 [153]

In memoriam

Në nderim e kujtim të Prof. Dr. Asti Papa i

MIKROFOSILET DHE MIKROFACIET TE DEPOZITIMEVE KARBONATIKE ME MOSHE APTIAN I POSHTEM (BEDULIAN) NGA MYÇHASI (HASI), ZONA

GJEOLGJIKE MIRDITA

ANDREEA UTA^{1*} & BARDHYL MUCEKU²

¹Instituti i Gjeoshkencave, Don Bosko Nr. 60, Tiranë, Shqipëri

²Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

*Autori korrespondent: andrea.uta@gmail.com

(Dorëshkrim i dorëzuar në shtator 2024; i pranuar për botim në nëntor 2024)

ABSTRAKT

Për të përcaktuar mjediset paleodepozicionale dhe evolucionin gjeodinamik të zonës gjeologjike të Mirditës gjatë Jurasikut të sipërm – Kretakut të poshtëm dhe në mënyrë implicite të kohës së vendosjes së depozitimeve ofiolitike, u zgjodhën disa zona me modele të ndryshme sedimentare: facie sedimentare të jashtme të Jurasikut të sipërm – Kretakut të Poshtëm (Beriasian i sipërm – Valanginian i poshtëm) dhe facie sedimentare të brendshme të moshës Barremian i sipërm – Aptian i poshtëm, që u analizuan në detaje nëpërmjet studimeve mikropaleontologjike dhe mikrofaciale. Kështu, mbi bazën e të dhënave mikropaleontologjike dhe mikrofaciale, në zonën e Myçhasit janë përcaktuar mjedise tipike të zonës së brendshme të platformës së brendshme, me tendenca restriktive dhe me moshë Aptian i poshtëm (Bedulian).

Fjalë kyçe: Myçhasi, Hasi, Aptian i poshtëm, Bedulian, mikrofacie, mikrofaunë, foraminifera.

HYRJE

Depozitimet e Kretakut kanë përhapje të gjerë në zonën e Mirditës. Nga veriu në jug ato fillojnë në rajonin e Hasit (mali i Pashtrikut) ku formojnë një masiv të madh, me vazhdimësi edhe në territorin e Kosovës. Më në jugperëndim vijojnë depozitimet e Kretakut të Malit të Shenjtë, që përbëjnë një nga daljet me sipërfaqe më të madhe dhe me trashësi të (malet e Zepës, Dejës etj.). Në rajonin mes lumenjve Fani i Madh dhe Fani i Vogël shtrihen depozitimet të Kretakut i Munellës, tepër i njohur veçanërisht për karstin madhështor në trajtën e hojeve të bletës, në lartësi mbi 1700 m. Kretaku, në rrjedhën e mesme të lumit Shkumbin përfaqëson një tjetër dalje me sipërfaqe të madhe dhe tepër potente në rajonet qendrore të Zonës së Mirditës. Në rajonet jugore, depozitimet e Kretakut kanë përhapje në zonat e Voskopojës, Polenës, Rehovës dhe Radanjit.

Studimi i depozitimeve të Kreta-

kut krahas atyre Jurasiko – Kretake është me rëndësi të madhe për të kuptuar evolucionin e Zonës së Mirditës (Fig. 1) pas mbylljes së basenit oqeanik. Për fat të mire, Shqipëria jep mundësi të mëdha studimi dhe ky fakt reflektohet në studimet e shumta të realizuara nga studiuesit shqiptarë (Arkaxhiu 1987; Peza 1983, 1985, 1989, Bushi & Arkaxhiu 1971; Peza et al. 1981, 1983, 1988; Dodona 1982, 1984; Marku 2000, 2002; Shehu et al. 1981, 1990; Xhomo et al. 2002, 2005), të cilët kanë realizuar dhe përgjithësuar studime të rëndësishme që e kanë rritur së tepërmi njohjen gjeologjike për këto depozitime. Edhe mjaft studiues të huaj që nga shekulli i kaluar e deri në ditët tona kanë kontribuar për njohjen e Kretakut të zonës së Mirditës (Nowack 1929; Schlagintweit et al. 2006, 2008, 2012).

Ajo që dallohet në përhapjen e depozitimeve Kretake është deformimi i pakët i këtyre depozitimeve, duke u shfaqur ose si struktura të mëdha

monoklinale (mali i Pashtrikut) ose si struktura të qeta brahisinklinale të përmasave të mëdha (Munella, Shejnti, Polisi, Radanji).

Të dhënat e këtij studimit sjellin të reja tepër të rëndësishme që shtrojnë nevojën e studimeve shtesë dhe që do të çojnë në interpretime të reja, të ndryshme nga ato tradicionale, veçanërisht për kufijtë formacionale mes depozitimeve Jurasiko – Kretake dhe të Kretakut. Përgjithësisht nga

shumica e gjeologëve është pranuar se depozitimet e Kretakut shtrihen transgresivisht mbi formacionet e poshtështruara me konglomerate të Barremian – Aptianit e më të reja mbi ato konglomerate. Të dhënat e përfuara nga prerjet e kryera në këtë studim në malin e Munellës dhe në atë të Shenjtit dëshmojnë për një situatë gjeologjike mjaft të ndryshme dhe do të trajtohen në mënyrë të detajuar në vijim.




Figura 1. Harta Gjeologjike me ndarjet tektonike dhe prerje të Albanideve (sipas Muceku et al. 2008).

Në Shqipëri, mjaft studime (Peza 1983, 1985, 1989; Peza et al. 1981, 1983, 1985, 1988; Dodona 1982, 1984; Schlangintweit et al. 2006, 2009) kanë trajtuar mikrofaciet urgoniane në këtë zonë dhe kështu, qëllimi ynë kryesor ka qenë përshkrimi i llojeve kryesore të mikrofacieve të tilla, përcaktimi i mikrofosileve me rëndësi biostratigrafike dhe rindërtimi sa i të saktë i mjediseve depoziçionale. Për ta arritur këtë qëllim, u studiuan gjashtë (6) prerje stratigrafike.

Në shumicën e depozitimeve në të gjithë zonën e Mirditës, vazhdimësia sedimentare e Kretakut të poshtëm përbëhet nga depozitime karbonatike tipike të ujërave të cekëta, të cilat u populluan tërësisht nga bashkëshoqërime pothuajse ekskluzivisht bentike (kryesisht foraminifere dhe alga gëlqerorë). Prandaj, në mungesë të organizmave tipike të mjediseve detare pelagjike (amonitë, foraminifera planktonike etj.), të cilat zakonisht përdoren në biostratigrafinë me rezolucion të lartë, foraminifera bentike dhe algat gëlqerorë luajnë një rol kryesor në datimin kronologjik të evolucionit të zonës në fjalë.

Në depozitimet e Kretakut të Poshtëm nuk përfshihen nivelet me moshë Beriasian – Valanzhinian, të cilët janë përshkruar së bashku me depozitimet e Titionianit të sipërm. Zakonisht nivele të ndryshme të depozitimeve të Kretakut të Poshtëm shtrihen transgresivisht mbi shkëmbinjtë më të vjetër. Sipas studimeve të kryera deri më sot, nivelet më të poshtme të Barremian – Aptianit shtrihen mbi depozitimet e Titionian – Valanzhinianit (Krej – Lurë, Shëngjin, Kurbnesh, Babje) ose mbi shkëmbinjtë ofiolitikë (Qafë Komi, Kumbull, Vilan, Liqeni i Kuq, Farret, Bishnicë – Voskop, Kamenë, Radanj). Në Krej – Lurë ato vendosen nëpërmjet një horizonti boksitesh mbi facien kryesisht gëlqerore të Titionian – Valanzhinianit (Peza et al. 1983).

Sipas studimeve të kryera, Barremian – Aptianit në rajonin e Kukësit i përket korja e prishjes së shkëmbinjve ultrabazikë si dhe ndërthurja (5 – 35 m) e argjilo – silicorëve të kuq me ranorë ofiolitikë, argjila të kuqe e gëlqerorë mergelore (Peza et al. 1989). Gjatë Aptianit dhe Albanit pellgu i Kretakut të Poshtëm u zgjerua më tej sidomos në drejtim të verilindjes në rajonin Krumë – Surroj. Gjithkund mbizotëron sedimentimi karbonatik i pasur me orbitolinide dhe me harofite. Në Pashtrik dhe Domen, në disa nivele takohen dhe thjerrza të rralla silicorësh.

NDËRTIMI GJEOLJIK

Prerja e Hasit (Myçasit) ndodhet në afërsi të fshatit Myças (Fig. 2), vetëm dhjetëra metra mbi shtëpitë e fshatit. Së pari, vemë në dukje se depozitimet e Kretakut të Hasit përfaqësojnë një nga vendpërhapjet më të mëdha të Kretakut të Zonës së Mirditës. Një pjesë e mirë e këtyre depozitimeve vijojnë edhe në territorin e Kosovës (Fig. 2). Në Myças kemi të bëjmë me pjesën më të poshtme të prerjes së depozitimeve Kretake të Hasit, gjë që vërtetohet me strukturën monoklinale të gëlqerorëve me rënie të vijueshme drejt lindjes. Si bazament i depozitimeve Kretake janë shkëmbinjtë ultrabazikë. Mbi to kemi një trashësi rreth 20 m të lateriteve të Fe – Ni dhe pas një trashësie të kufizuar (4 – 5 m) të konglobreçieve vijojnë gëlqerorët e ujërave të cekëta, ku ne kemi kryer prerjen. Janë marrë gjithsej 90 kampione në një trashësi prej 300 m shkëmbinj gëlqerorë.




Figura 2. Gjeologjia e rajonit të Hasit (sipas Xhomo et al. 2005 me plotësimet dhe ndryshime).

METODOLOGJIA

Në punimet në terren, seksioni stratigrafik i përzgjedhur u studiua dhe u interpretua në lidhje me litologjinë, mikrofacionet dhe përmbajtjen e faunës me lupë dhe në varësi të kësaj u mbledhën kampionët. Gjatë studimeve laboratorike janë bërë analiza të detajuara mikropaleontologjike dhe mikrofacionale dhe për këto analiza janë përgatitur më shumë se 100 shlife. Analizat mikropaleontologjike janë bërë duke hetuar morfologjinë e individëve (kryesisht foraminiferat, algat gëlqerore dhe mikro- ose makroorganizma të tjera) dhe individët që u përkasin çdo specie janë fotografuar dhe klasifikuar sipas hierarkisë taksonomike. Më pas, u bë përcaktimi dhe klasifikimi i foraminiferave dhe organizmave të tjerë, duke përdorur përhapjen e tyre stratigrafike. Analizat mikrofacionale të këtyre kampionëve janë bërë duke përfshirë studimin e çdo kampioni bazuar në vetitë e tij tekurale (bollëkun dhe llojet e allokemeve dhe matriksit). Ndryshimet vertikale në llojin e mikrofacioneve dhe përmbajtjen mikropaleontologjike janë përdorur

në interpretimin e evolucionit të depozitimeve karbonatike në fjalë.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Në vazhdim jepet një përshkrim i hollësishëm mikropaleontologjik dhe mikrofacional i një numri prej 100 kampionëve të grumbulluar sistematikisht përgjatë prerjes, duke përcaktuar mikrofacionet dhe bashkëshoqërimet e tyre mikropaleontologjike kryesisht nëpërmjet përcaktimit të foraminiferëve bentikë, të përfaqësuar jashtëzakonisht mirë në këtë prerje dhe gjithashtu edhe mikroorganizma të tjerë.

Wackestone bioklastik

Është një mikrofacion që karakterizohet nga prania e foraminiferëve bentikë të përfaqësuar kryesisht nga miliolide të vogla, ku format me guaskë të hollë, si: *Istrilocolina elliptica* (Pl. 6: fig. 95) dhe *Istrilocolina* sp. (Pl. 6: figs. 106 – 110) janë të përfaqësuar mirë dhe të shoqëruara nga *Glomospira urgoniana* (Pl. 6: figs. 96 – 105), *Glomospira* sp., *Chofatella decipiens* (Pl. 1: fig. 18), *Praechrysalidina*

infracretacea, *Mayncina bulgarica* (Pl. 1: fig. 2), *Charentia cuvillieri* (Pl. 1: figs. 3 – 4), *Everticyclammina* sp. (Pl. 1: fig. 17), *Bolivinopsis labelosa* (Pl. 3: fig. 18), *Sabaudia minuta*, *Melathrokerion* sp., *Amobaculites* sp., *Arenobulimina* sp., *Conorboides* sp., *Novalesia* sp. (Pl. 2: fig. 35 – 36; Pl. 3: fig. 37), *Reophax* sp., *Spiroloculina* sp., *Quinqueloculina* sp., *Cayeuxia* sp., *Salpingoporella muehlbergii* (Pl. 7: fig. 119), tekstularide të ndryshme dhe fragmente ostrakodesh. Shfaqet alga gëlqerore *Salpingoporella dinarica* (Pl. 7: fig. 118) e cila do të jetë prezente gjatë një pjese të rëndësishme të prerjes dhe në disa raste është shkëmbformuese. Shkëmbi është i prerë nga çarje dhe boshllëqe me përmasa, forma dhe orientime të ndryshme dhe është mjaft poroz.

Wackestone – packestone bioklastik

Kjo mikrofacie përmban foraminifera bentike të ndryshme si: *Debarina hahounerensis* (Pl. 1: fig. 8), *Mayncina bulgarica* (Pl. 1: figs. 7, 9, 10, 12, 13), *Ammobaculoides aff. plumerae* (Pl. 3: fig. 41), *Bolivinopsis* sp., *Arenobulimina* sp. (Pl. 2: figs. 25, 27, 33), *Dobrogelina? cartusiana* (Pl. 2: figs. 28 – 29, 32), *Dobrogelina* sp. (Pl. 2: fig. 60), *Belorussiella* sp. (Pl. 3: fig. 52), *Pseudotextulariella* sp. (Pl. 3: fig. 40), *Chofatella decipiens*, *Sabaudia minuta*, *Istriloculina* sp., *Quinqueloculina* sp., *Glomospira* sp., *Valvulineria* sp., *Bolivinopsis* sp. (Pl. 3: fig. 38), *Rivularia* sp. dhe fragmente ostrakodesh. Shkëmbi është i prerë nga çarje me përmasa dhe orientime të ndryshme dhe nga struktura gjeopetale të mbushura me sediment të imët, me përmasa siltike dhe është i pigmentuar me lëndë Fe. Kjo mikrofacie karakterizohet gjithashtu nga prania e strukturave fenestrave, ku fenestrat mund të përbëhet nga zgavra të hapura ose nga boshllëqe të mbushura plotësisht ose pjesërisht me sediment silt vadoz ose produkte diagentike (silt me okside të hekurit ose çimento).

Strukturat fenestrave dhe gjeopetale

shfaqin morfologji të ndryshme: eliptike, me një bazë ovale dhe formë të çrregullt të pjesës së sipërme, ndërsa madhësitë ndryshojnë nga milimetra deri në nënmillimetra, dhe janë të mbushura me silt vadoz ose kokrriza skeletore dhe peloide. Si rregull, fosilet janë të pakta në këto mikrofacie. Ndonjëherë, ata mund të përmbajnë fragmente rudistesh.

Wackestone – packestone onkolitit peloidal me cianobaktere të tipit *Cayeuxia* sp. të onkolitizuara.

Shkëmbi është mjaft poroz.

Wackestone packestone bioklastik me rudiste të vegjël

Rudistet janë forma të vogla të species *Mathesia darderi*, të cilat janë shumë tipike për depozitimet me moshë Baremian i sipërm – Aptian i poshtëm, të përshkruara deri më tani vetëm nga Spanja dhe Bullgaria nga Masse & Fenerci-Masse (2010, 2011). Në matriksin mikritik shfaqen disa foraminifera si: *Istriloculina* sp., *Quinqueloculina* sp., *Sabaudia minuta*, *Valvulineria* sp., *Charentia cuvillieri*. I njëjti nivel me *Mathesia darderi* është identifikuar edhe në prerjen e Shenjti 2, Laramani dhe Shëngjini (Uta 2021).

Wackestone bioklastik të imët

Është një mikrofacie që përmban një mikrofaune të përfaqësuar nga forma si: *Chofatella decipiens*, *Charentia cuvillieri*, *Sabaudia minuta*, *Istriloculina* sp. (Pl. 6: fig. 110; Pl. 7: fig. 113), *Bolivinopsis* sp., *Arenobulimina* sp., alga *Salpingoporella dinarica* dhe fragmente ostrakodesh.

Wackestone bioklastik me *Salpingoporella dinarica*

Kjo mikrofacie karakterizohet nga prania e bollshme e *Salpingoporella dinarikes* dhe gjithashtu të foraminifereve bentike si: *Praechrysalidina infracretacea*, *Charentia cuvillieri*, *Charentia* sp., *Sabaudia minuta*, *Istri-*

loculina sp., *Quinqueloculina robusta* (Pl. 7: fig. 112), *Quinqueloculina* sp. (Pl. 7: figs. 111, 114), *Glomospira urgoniana*, *Glomospira* sp., *Valvulineria* sp., *Conorboides* sp., *Gaudryina* sp. dhe ostrakodeve të tjerë. Shkëmbi karakterizohet nga prezencja e strukturave gjeopetale dhe shfaqjen e çarjeve shumë të imta.

Wackestone – packestone bioklastik peloidal

Është një mikrofacie shumë e pasur në foraminifere bentike si: *Chofatella decipiens*, *Charentia cuvillieri*, *Pfenderina aureliae*, *Glomospira* sp., *Istriloculina* sp., *Quinqueloculina* sp., *Textularia* sp., *Valvulineria* sp., *Gaudryina* sp., *Arenobulimina* sp., *Earlandia* sp., algen *Salpingoporella dinarica* (Pl. 7: figs. 120 – 121, 126), *Cayeuxia* sp., gastropode dhe fragmente krioidesh.

Mudstone intraklastik – bioklastik

Në këtë mikrofacie shfaqen foraminifere si: *Mayncina bulgarica*, *Chofatella decipiens*, *Debarina hahouensis*, *Pfenderina aureliae*, *Sabaudia minuta*, *Sabaudia* sp., *Pseudocyclamina lituus* (Pl. 2: fig. 19), *Evertycyclamina* sp. (Pl. 2: figs. 20 – 23), *Quinqueloculina* sp., *Valvulineria* sp., *Bolivinopsis* sp. (Pl. 3: figs. 42 – 45), *Glomospira* sp. dhe intraklaste mikritike.

Mudstone wackestone me *Istriloculina* sp.

Këtu mikrofauna është e përfaqësuar vetëm nga disa specimene të *Istriloculina* sp. dhe fragmente gastropodesh ose pothuajse mungon.

Wackestone bioklastik me miliolide dhe *Istriloculina* sp.

Milliolidet janë foraminiferat që mbizotërojnë në këto mikrofacie. Në përgjithësi mikrofaciet përmbajnë boshllëqe të mbushura me sediment shumë të imët. Duke filluar me kampionin H46 shënohet një ndryshim

në përmasën e mikrofaunës, si për shembull tek miliolidet, me shfaqjen e miliolideve të mëdhej dhe gjithashu shfaqjen e orbitolinideve.

Wackestone bioklastik

Kjo mikrofacie përmban *Sabaudia minuta*, miliolide të mëdha si: *Quinqueloculina* sp. të karakterizuara nga prezencja e porozitetit moldik, *Derventina* sp. (Pl. 7: figs. 115, 117), *Rumanoloculina* sp., *Mayncina bulgarica*, *Vercorsella scarsellai*, *Vercorsella arenata* (Pl. 4: figs. 66 – 67; Pl. 5: figs. 77, 82), *Vercorsella* sp. (Pl. 4: figs. 65, 68; Pl. 5: figs. 79 – 80), *Cuneolina parva* (Pl. 4: figs. 56 – 57; Pl. 5: fig. 86), *Nautiloculina cretacea*, *Melathokerion valserinensis*, *Pfenderina globosa*, *Pfenderina aureliae*, *Pseudocyclamina lituus*, *Charentia cuvillieri* (Pl. 1: figs. 6, 11, 14-15), *Sabaudia minuta* (Pl. 4: figs. 58 – 59, 70, 72 – 74; Pl. 5: fig. 75), *Sabaudia capitata* (Pl. 4: figs. 61 – 64, 69, 71; Pl. 5: figs. 76, 78, 81, 83 – 85), *Nezazzata isabellae*, *Rumanoloculina* sp., *Glomospira urgoniana*, *Textularia* sp., *Valvulineria* sp., *Novalesia* sp., *Gaudryina* sp., *Rivularia* sp., fragmente gastropodesh, rudistesh, ekinodermash. Në kampionin H52 fillon shfaqja e orbitolinideve. Në disa raste shfaqen gjurmë bioturbacioni (kampioni H69a).

Wackestone bioklastik me rudiste të vegjël

Mudstone – wackestone me harofite

Kjo facie përmban cjanobaktere si: *Rivularia* sp. (Pl. 7: figs. 127 – 128), dhe *Girvanella* sp. (Pl. 7: figs. 122 – 123), *Istriloculina* sp., harofite (Pl. 7: figs. 124 – 125), me struktura gjeopetale, tipike e mjediseve restriktive.

Wackestone – packestone bioklastik-onkolitik

Kjo mikrofacie është e karakterizuar nga prezencja e orbitolinideve si: *Mesorbitolina texana* (Pl. 5: fig. 90), *Paleodictyoconus arabicus* (Pl. 5: figs. 87, 89, 92; Pl. 6: figs. 93 – 94),

Paracoskinolina sp. (Pl. 5: fig. 88), *Orbitolina* sp., miliolide të mëdhej, *Charentia cuvillieri*, *Chofatella decipiens*, *Pseudocyclammia lituus*, *Andersenina rumana*, *Sabaudia minuta*, *Cuneolina* sp., *Novalesia* sp., *Istriloculina* sp., *Glomospira* sp., *Arenobulimina* sp., forma të mëdha dhe të vogla, *Bolivinopsis* sp. (Pl. 3: figs. 47 - 55), *Textularia* sp. dhe *Valvulineria* sp.

Mudstone – wackestone me orbitolinide Mudstone të fenestruara

Përhapja e faunës bentike, veçanërisht ajo e foraminiferave, algave gëlqerore dhe makroorganizmave është në varësi të kushteve ekologjike lokale. Foraminiferat në veçanti janë mjete bistratigrafike të rëndësishme sepse ato zakonisht evoluojnë me shpejtësi, janë të bollshme dhe të përhapura dhe speciet ose grupet e specieve shpesh zhduken mjaft papritur (Hallock 1982). Prandaj, shumë specie mund të përdoren për korrelacione lokale dhe rajonale. Në mungesë të amoniteve dhe foraminifera planktonike, domethënë të organizmave të njohur për vlerën e tyre stratigrafike me rezolucion të lartë, përcaktimet moshore të prerjes stratigrafike të Myçhasit, bazohen në mënyrë tipike në organizmat bentike: foraminiferat dhe algat gëlqerore. Këto organizma zakonisht kalibrohen biostratigrafikisht më ato lokalitete të arealit tetisian, ku bashkëshoqërime bentike të ngjashme gjenden në shoqërim me amonite ose foraminifera planktonike. Më poshtë, do të evidentohen speciet kryesore të foraminiferave bentike dhe algave gëlqerore, të intervalit Baremian – Aptian të zonës në studim, për të sqaruar pozicionet e tyre stratigrafike dhe përmbledhur rezultatet kryesore të diskutimit me theks në të dhënat nga platforma karbonatike Mirdita.

Në prerjen e Hasit, *Palorbitolina lenticularis*, foraminiferi orbitolinid më i zakonshëm dhe stratigrafikisht i rëndësishëm, është i njohur nga lokalitete të shumta me moshë Aptian i poshtëm. *Salpingoporella dinarica*,

e cila gjendet me bollëk në prerjet e Hasit, Shenjti 2, Laramani, Shëngjini, është një specie e njohur që shfaqet shpesh dhe me bollëk në të gjithë Mesdheun. Megjithëse njihet nga depozitimet më të vjetra (Radoicic' 1967; Sokac 1996), është më e zakonshme në intervalin Baremian i sipërm deri në fund të Aptianit.

Në lidhje me biostratigrafinë e Aptianit, disa autorë përdorin një ndarje bipartite (Bedoulian = i hershëm, Gargasian + Clansayesian = Aptian i vonshëm) (p.sh.: Schroeder et al. 2010) ndërsa të tjerët preferojnë një ndarje trepartite (Bedoulian = i hershëm, Gargasian = i mesëm, Clansayesian = Aptian i vonshëm) i këtij kati (p.sh.: Castro et al. 2002; Gradstein et al. 2004). Masse (2003), përveç kësaj dalloi edhe një Bedoulian të poshtëm?/të hershëm (zona amonitike të *Deshayesites* + *D. weissi*) dhe një Bedoulian të sipërm?/të vonshëm (zonat amonitike me *D. deshaysi* dhe *Dufrenoya furcata*). Stratigrafia e seksionit të studiuar bazohet në foraminifera bentike dhe të dhënat mbështetëse që vijnë nga algat dasikladale dhe foraminifera të tjera bentike.

Një gjini shumë e rëndësishme është *Mesorbitolina texana*, e cila u përshkrua nga Gawlick (2008) në pjesën e sipërme të prerjes së Malit të Shenjtë dhe nga Schroeder (1964) nga Urgoniani i Spanjës. Nëpërmjet punimeve të tjera kjo moshë u korrigjua, duke aktuar shfaqjen e parë të *Reophax giganteus* në pjesën e poshtme Aptianit të hershëm (Cherchi & Schroeder 1999; Schroeder et al. 2002; Schroeder et al. 2010). Shfaqja e këtij taksoni duhet të kufizohet në pjesën më të poshtme të Aptianit të hershëm (Bedoulian) (Schroeder 1964; Schroeder et al. 2010). Kjo specie u identifikua edhe në prerjen e këtij studimit.

Duke rishikuar literaturën, Masse (2003), arriti në përfundimin se *Reophax giganteus* është një shënues për moshën beduliane dhe se të

dhënat nga Spanja i sugjerojnë një moshë Bedulian i poshtëm/i hershëm. Shpërndarja biostratigrafike e *Mesorbitolina texanes* shpesh tregon një moshë Aptian i sipërm (= Clansayesian) deri në Albanian i mesëm (Schroeder 1975, 1985; Velić 2007). Një analizë të plotë të prerjeve të ndryshme nga Spanja, prerje të cilat përmbajnë orbitolinide, foraminifere planktonike dhe amonite (Castro et al. 2002) ka treguar se *M. texana* arin deri në pjesën e sipërme të Gargasianit brënda zonës me foraminiferin planktonik *Globigerinelloides algerianus* (= pjesa e sipërme të zonës amonitike me *Parahoplites melchioris*, Ropolo et al. 2008). Në një skemë të re biostratigrafike të orbitolinideve të Baremian – Albanianit, shfaqja e parë e *Mesorbitolina texanes* tregohet si pjesë e mesme të Gargasianit (baza e zonës amonitike me *P. melchioris*) (Schroeder et al. 2010).

Gjatë këtij studimit, ka qenë e mundur të përcaktohet numri maksimal të organizmave deri në nivelin e specieve dhe përveç kësaj, disa taksonë janë identifikuar vetëm deri në nivele të gjinisë (*Salpingoporella*, *Belorusiella*, *Bolivinopsis*, *Everticyclamina*, *Nubecularia*? *Pseudocyclamina*, *Pseudolituonella*, *Arenobulimina*, *Valvulinera*?).

Shkurtimisht, në vazhdim jepen disa forma me rëndësi biostratigrafike për moshën Baremian – Aptian: *Charentia cuvillieri* Neumann 1965 (Përhapja biostratigrafike: Heterivian – Cenomanian i Tetisit Mesdhetar), *Choffatella decipiens* Schlumberger 1905 (Përhapja biostratigrafike: Heterivian – Aptian), *Debarina hahounerensis* Fourcade, Raoul et Vila 1972 (Përhapja biostratigrafike: Baremian i sipërm – Aptian), *Glomospira urgoniana* Arnaud-Vanneau 1980 (Përhapja biostratigrafike: Baremian – Aptian), *Istriloculina elliptica* Lovcheva 1962 (Përhapja biostratigrafike: Baremian – Aptian i poshtëm; u përshkrua fillimisht nga Aptian i Bullgarisë dhe është regjistruar përgjatë kufijve të Tetisit; Arnaud-Vanneau & Sliter

1995), *Palorbitolina lenticularis* Blumenbach 1805 (Përhapja biostratigrafike: Baremian i vonshëm – Aptian i hershëm; është i shpërndarë gjerësisht në arealin tetisian), *Pfenderina aureliae* Neagu 1979 (Përhapja biostratigrafike: Baremian i sipërm – pjesa më e poshtme e Aptianit), *Praechrysalidina infracretacea* Luperto Sinni 1979 (Përhapja biostratigrafike: Baremian i vonshëm – Aptian i hershëm), *Melathrokerion valserinensis*, Brönnimann & Conrad 1967 (Përhapja biostratigrafike: Baremian – Aptian i hershëm).

Mosha e prerjeve është Baremian i sipërm – Aptian i poshtëm, ku në prerjen e Myçhasit, për shkak të formave të përshkruara, si orbitolinidet, format e tjera indeks dhe gjithashtu bashkëshoqërimet e *Salpingoporella dinarica* – *Chofatella decipiens* dhe *Salpingoporella dinarica* – *Praechrysalidina infracretacea* janë tipike për intervalin Aptian i poshtëm, nënkati Bedulian.

Konsiderata paleoekologjike

Janë identifikuar tre zona faciale të ndara në disa lloje microfaciesh të cilat variojnë nga supratidal, intertidal (i kufizuar), intertidal (laguna e hapur). Mikrofaciet e përcaktuara janë mudstone bioklastikë, packstone dhe wackestone ferestrale, wackestone bioklastike dhe packstone bioklastikë.

Në prerjet e studiuara, shfaqja e bollshme të gjinive *Chofatella*, *Melathrokerion*, *Sabaudia*, *Vercorsella* ose të orbitolinideve, sëbashku me forma tipike mjedisëve të kufizuara/restruktive si *Istriloculina* dhe *Glomospira*, gjithashtu edhe interpretimi tekstural të facieve dominuese (wackestone – packstone) sugjeroi një mjedis të qetë, tipik mjedisëve të brendshme të platformave karbonatike me moshë kretake.

Salpingoporella dinarica është një specie shumë tolerante ndaj luhatjeve të faktorëve mjedisore, siç

trëgohet nga fakti se lulëzoi në mjediset me energji të ulët, të kufizuara. Facie të tilla si ato të përshkruara gjatë prerjes të Myçhasit në formë të wackestoneve algore me *Salpingoporella dinarica*, janë facie shumë tipike e pjesëve të mjediseve të kufizuara/restriktive të platformave karbonatike me moshë Aptiane. Bashkëshoqërimi i tyre me ostrakodet, harofitet dhe foraminiferet tipike këtyre mjediseve si *Istriloculina* dhe *Glomospira*, të cilët i takojmë me bollëk kryesisht në prerjen e Myçhasit, tregojnë praninë e pellgjeve tipike lagunave shumë të mbrojtura.

Mënyra e jetesës të foraminiferëve të përcaktuara gjatë prerjeve ku mbizotërojnë format epifaunale (*Glomospira* sp., *Quinqueloculina* sp., *Lenticulina* sp., *Charentia* sp., *Nezzazata* sp., *Haplophragmoides* sp., *Istriloculina* sp., *Pseudocyclammina* sp.), pastaj forma infaunale (*Gaudryina* sp., *Pseudolituonella* sp., *Praechrysalidina* sp., *Bolivinopsis* sp., *Ammobaculites* sp., *Haplophragmoides* sp.). Bashkëshoqërimet foraminiferale të mbizotëruar nga forma epifaunale dhe forma infaunale me guaskë të aglutinuar si *Pseudocyclammina lituus* dhe *Everticyclammina* sp. dhe me natyre kalcitike, janë në përputhje me një përmbajtje të lartë të lëndës ushqyese ekzistuese në sediment, si dhe me një disponueshmëri të ulët të oksigjenit (Reolid et al. 2008). Format baltë – gërmuese si *Istriloculina* sp. dhe *Glomospira* sp. janë të pranishme kryesisht në faciet mikritike dhe të kufizuara/restriktive, shumë tipike e mjediseve depozicionale të

prerjes stratigrafike të Hasit.

Ostrakodet, të përshkruara gjatë prerjeve të mësipërme tregojnë mjedisë afër bregdetit me një gamë të gjerë të luhatjeve të temperaturës dhe kripësisë.

PËRFUNDIME

Mbi bazën e analizave mikropaleontologjike dhe mikrofaciale, në zonën e Myç-Hasit janë përshkruar 3 zona faciale të ndara në disa lloje mirofaciesh, të cilat variojnë nga supratidal, intertidal (i kufizuar), intertidal (laguna e hapur). Mikrofaciet e përcaktuara janë mudstone bioklastikë, packestone dhe wackestone ferestrale, wackestone bioklastike dhe packestone bioklastikë. Bashkëshoqërimet mikrofaunistike tregojnë një moshë Aptian i poshtëm. Në Myç - Hasit ato shtrihen mbi depozitimet lateritike të Fe-Ni dhe formacioneve mantelore ultrabazike. Më në lindje vijojnë depozitime kretake gjithnjë e më të reja. Në territorin e Kosovës, në krahinën e Hasit moshë e gëlqerorëve kretakë është Senonian. Pra moshë e depozitimeve kretake me shtrirje mbi ofiolitet dhe mbulesën e tyre parësore është më e vjetër në pjesët qendrore të Zonës së Mirditës dhe rinohet gjithnjë e më tepër drejt lindjes – verilindjes.

Falenderime


Falenderojmë Prof. Dr. Avni Meshi për udhëzimet e vlefshme në lidhje me prerjen e Myçhasit.

REFERENCAT


- ARKAXHIU F. (1981).** EVOLUCIONI PALEOGJEOGRAFIK DHE KUSHTET E FORMIMIT TË PRODHIMEVE TË TJETËRIMIT (LAT-ERITIK) NË RAJONIN LIBRAZHD-POGRADEC. *BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, NR. 1, TIRANË.
- BUSHI E. & ARKAXHIU F. (1971).** TË DHËNA MBI NDËRTIMIN GJEOLGO – STRUKTUROR TË ZONËS BUSHTRICË-PRRENJAS E BERZESHË. *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, NR. 4, TIRANE.
- CASTRO J.M., COMPANY M., DE GEA G.A. & AGUADO R. (2001).** BIOSTRATIGRAPHY OF THE APTIAN – MIDDLE CENOMANIAN PLATFORM TO BASIN DOMAIN IN THE PREBETIC ZONE OF ALICANTE, SE SPAIN: CALIBRATION BETWEEN SHALLOW WATER BENTHONIC AND PELAGIC SCALES. *CRETACEOUS RESEARCH*, 22, 145-156. DOI: 10.1006/CRES.2000.0249
- CERCHI A. & SCHROEDER R. (1999).** *MONTSECIELLA*, A NEW ORBITO-LINID GENUS (FORAMINIFERIDA) FROM THE UPPERMOST HAUTERIVIAN – EARLY BARREMIAN. *TREB. MUS. GEOL. BARCELONA*, 8, 5–23.
- DODONA E. (1982)** STRATIGRAFIA, MIKROFACIET DHE MIKROFAUNA E ZONES MIRDITA. DISERTACION.
- HALLOCK P. (1982).** EVOLUTION AND EXTINCTION IN LARGER FORAMINIFERA. *MARINE SCIENCE FACULTY PUBLICATIONS*, FQ. 1229.
- MARKU D. (2000).** MBI TRANSGRESIONIN E BAREMIANIT NË RAJONIN E MUNELLËS (ZONA MIRDITA QËNDRORE) DHE NDRYSHIMIN E SKENËS STRATIGRAFIKE. *KONGRESI I 8-TE SHQIPTAR I GJEO SHKENCAVE*, FQ. 104.
- MARKU D. (2002).** RAPORT SHKENCOR I PROJEKTIT V-1b “KRETAKU I RAJONIT ZEPEGURI I NUSES” (REPORT OF THE PROJECT V1b CRETACEOUS OF THE ZEPE-GURI I NUSES AREA). *ARKIVI QENDROR TEKNIK I GJEOLOGJISË, SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR*, FQ. 62.
- MASSE J.-P. (2003).** INTEGRATED STRATIGRAPHY OF THE LOWER APTIAN AND APPLICATIONS TO CARBONATE PLATFORMS: A STATE OF THE ART.– IN: GILI, H.N. & SKELTON, P.W. (EDS.): NORTH AFRICAN CRETACEOUS CARBONATE PLATFORM SYSTEMS, NATO SCIENCE SERIES, IV. *EARTH AND ENVIRONMENTAL SCIENCES, KLUWER ACADEMIC PUBLISHERS*, 28, 215–227.
- NOWACK E. (1929).** GEOLOGISCHE UBERSCHIFT VON ALBANIAN. ERLANTERUNG ZUR GEOLOGISCHEN KARTA 1:200000, SALZBURG.
- PEZA L.H., XHOMO A. & THEODHORI P. (1973).** STRATIGRAFIA E DEPOZITIMEVE MEZOZOIKE TË ZONËS SË ALPEVE SHQIPTARE. *GEOFOND ISPGJ TIRANA*, FQ. 377 (UNPUBLISHED REPORT).
- PEZA L.H. (1981).** STRATIGRAFIA E DEPOZITIMEVE KRETAKE TË ZONËS SË ALPEVE SHQIPTARE DHE STUDIMI MONOGRAFIK I DISA MOLLUSQEVE. UNPUBLISHED PH.D. THESIS, FQ. 155, PL. 1-11, TIRANË.
- PEZA L.H., MARKU D. & PIRDENI A. (1981).** BIOSTRATIGRAFIA DHE PALEOGJEOGRAFIA E DEPOZITIMEVE KRETAKE TË RAJONIT TË MUNELLËS. *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, 2, 95-108.
- PEZA L.H., PIRDENI A. & TOSKA Z. (1983).** CRETACEOUS DEPOSITS AT KURBNESH – KREJLURA REGION AND DATA ON PALEOGEOGRAPHICAL DEVELOPMENT OF THE MIRDITA ZONE DURING UPPER JURASSIC – CRETACEOUS. *BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, 4, 71-90.
- PEZA L.H. & GARORI R. (1985).** STRATIGRAFIA E DEPOZITIMEVE KRETAKE TË ZONËS MIRDITA DHE PREMISAT PËR KËRKIMIN E MINERALIZIMEVE, QË LIDHEN ME TO. *GEO FOND ISPGJM* (UNPUBLISHED REPORT).
- PEZA L.H., JANI P., PETRO TH., THEODHORI P., PIRDENI A. & GARORI R. (1985).** DEPOTS DU TRIAS SUPERIEUR CLANS LA REGION DE ZEMBLAK (KORCE). *BULETIN I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, 4, 59-63.
- PEZA L.H. (1988).** *CRETACEOUS OF THE MIRDITA ZONE AND ITS MACRO FAUNA. UNPUBLISHED D. SC. THESIS VOL. I - GEOLOGY, FQ. 150, VOL. II - PALEONTOLOGY, FQ. 376, PL. L-76, TIRANA.*
- PEZA L.H. (1989).** A NEW NERINEID SPECIES (GASTROPODA): *TROCHOPTYGMATIS VINNJOLLENSIS* NOV. SP., FROM BARREMIAN-APTIAN DEPOSITS OF VINNJOLL (BMTEL). *BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, 2, 127-133, PL. L.
- PEZA L.H., SHKUPI D., TURKU I. & TEROLLI I. (1990).** GEOLOGY OF VERMOSHI REGION. *BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, 4, 39-55.
- PEZA L.H. & ZITT J. (2002).** URGONIAN (EARLY CRETACEOUS) ECHINOIDS OF THE MIRDITA ZONE (SOUTHEAST ALBANIA). *GEOLOGICA CARPATHICA*, 53/5, 327-332.
- PRELA M. (1994).** MIRDITA OPHIOLITE PROJECT: 1. RADIOLARIAN BIOSTRATIGRAPHY OF THE SEDIMENTARY COVER OF THE OPHIOLITES IN THE MIRDITA AREA (ALBANIA): INITIAL DATA. *OFIOLITI*, 9, 279-86.
- PRELA M., CHIARI M. & MARCUCCI M. (2000).** JURASSIC RADIOLARIAN BIOSTRATIGRAPHY OF THE SEDIMENTARY COVER OF OPHIOLITES IN THE MIRDITA AREA, ALBANIA: NEW DATA. *OFIOLITI*, 25(1), 55-62.
- REOLID M., RODRÍGUEZ-TOVAR F.J., NAGY J. & OLÓRIZ F. (2008).** BENTHIC FORAMINIFERAL MORPHOGROUPS OF MID TO OUTER SHELF ENVIRONMENTS OF THE LATE JURASSIC (PREBETIC ZONE, SOUTHERN SPAIN): CHARACTERIZATION OF BIOFACIES AND ENVIRONMENTAL SIGNIFICANCE. *PALAEOGEOGRAPHY, PALAEO- CLIMATOLOGY, PALAEOECOLOG*, 261, 280-299.

- ROPOLO P., CONTE G., MOULLADE M., TRONCHETTI G. & GONNET R. (2008).** THE DOUVILLEICERATIDAE (AMMONOIDEA) OF THE LOWER APTIAN HISTORICAL STRATOTYPE AREA AT CASSIS-LE BÉDOULE (SEFRANCE). *CARNETS DE GÉOLOGIE MEM.*, 3 (CG2008_M03).
- SCHLAGINTWEIT F., GAWLICK H.-J., LEIN R. & HOXHA L. (2012).** ONSET OF AN APTIAN CARBONATE PLATFORM, OVERLAYING A MIDDLE-LATE JURASSIC RADIOLARITIC-OPHIOLITIC MÉLANGE IN THE MIRDITA ZONE OF ALBANIA. *GEOLOGIA CROATICA*, 65/1, 29-40.
- SCHLAGINTWEIT F., GAWLICK H.-J., MISSONI S., LEIN R. & HOXHA L. (2006).** LATE JURASSIC TO EARLY CRETACEOUS DASYCLADALES AND BENTHONIC FORAMINIFERA FROM THE MUNELLA CARBONATE PLATFORM S.L. OF THE MIRDITA ZONE. *XIII-TH CONGRESS OF CARPATIAN-BALCAN GEOLOGICAL ASSOCIATION*, FQ. 527-530.
- SCHLAGINTWEIT F., GAWLICK H.-J., MISSONI S., HOXHA L., LEIN R. & FRISCH W. (2008).** THE ERODED LATE JURASSIC KURBNESH CARBONATE PLATFORM IN THE MIRDITA OPHIOLITE ZONE OF ALBANIA AND ITS BEARING ON THE JURASSIC OROGENY OF THE NEOTETHYS REALM. *SWISS J GEOSCI*, 101, 125-138.
- SCHROEDER R. (1964).** ORBITOLINIDEN-BIOSTRATIGRAPHIE DES URGONSNÖRDLÖSTLICH VON TERUEL (SPANIEN). *N. JB. GEOL. PALÄONT. MH.*, 462-472.
- SCHROEDER R. (1975).** GENERAL EVOLUTIONARY TRENDS IN ORBITOLINAS. *REV. ESP. MICROPALÉONT.*, NUM. SPEC., 117-128.
- SCHROEDER R. (1985).** *ORBITOLINA (M.) TEXANA* (ROEMER, 1849) – IN: SCHROEDER R. & NEUMANN M. (EDS.): LES GRANDS FORAMINIFÈRES DU CRÉTACÉ MOYEN DE LA RÉGION MÉDITERRANÉENNE. *GÉO-BIOS MÉM. SPÉC.*, 7, 77-80.
- SCHROEDER R., CLAVEL B., CHERCHI A., BUSNARDO R., CHAROLLAIS J. & DECROUZÉ D. (2002).** LIGNÉES PHYLÉTIQUES D'ORBITOLINIDÉS DE L'INTERVALLE HAUTERIVIEN SUPÉRIEUR – APTIEN INFÉRIEUR; LEUR IMPORTANCE STRATIGRAPHIQUE. *REV. PALÉOBIOL.*, 21, 853-863.
- SCHROEDER R., VAN BUCHEM F.S.P., CHERCHI A., BAGHBANI D., VINCENT B., IMMENHAUSER A. & GRANIER B. (2010).** REVISED ORBITOLINID BIOSTRATIGRAPHIC ZONATION FOR THE BARREMIAN – APTIAN OF THE EASTERN ARABIAN PLATE AND IMPLICATIONS FOR REGIONAL STRATIGRAPHIC CORRELATIONS. *GEOARABIA SPEC. PUB.*, 4, 49-96.
- SHEHU R. ET AL. (1990).** GJELOGJIA E SHQIPËRISE. *SHGJSH*, FQ. 306.
- UTA A. (2021).** MIKROPALÉONTOLOGIA, MIKROFACIET DHE PALEOMJEDISET SEDIMENTARE TE DEPOZITIMEVE KARBONATIKE ME MOSHE KRETAK I POSHTEM TE ZONES GJELOGJIKE MIRDITA DHE MARREDHENJET E TYRE ME FORMACIONET E POSHTESHTRUARA. FQ. 183 (DOKTORATURE E PABOTUAR).
- VELIC I. (2007).** STRATIGRAPHY AND PALAEOBIOGEOGRAPHY OF MESOZOIC BENTHIC FORAMINIFERA OF THE KARST DINARIDES (SE EUROPE). *GEOLOGIA CROATICA*, 60, 1-113.
- XHOMO A., KODRA A., XHAFA Z. & SHALLO M. (2002).** GJELOGJIA E SHQIPËRISË. *SHGJSH*, TIRANE, FQ. 404.
- XHOMO A., KODRA A., XHAFA Z. & SHALLO M. (2005).** HARTA GJELOGJIKE E SHQIPËRISË NË SHKALLËN 1:200 000. *SHGJSH*, TIRANË.


PLANSHA 1




PLANSHA 2




PLANSHA 3




PLANSHA 4




PLANSHA 5



PLANSHA 6



PLANSHA 7



MICROFOSSILS AND MICROFACIES FROM THE LOWER APTIAN (BEDOULIAN) CARBONATE DEPOSITS OF MYÇHASI (HASI), MIRDITA ZONE

ANDREEA UTA^{1*} & BARDHYL MUCEKU²

¹Institute of Geosciences, Don Bosko Nr. 60, Tirana, Albania

²Polytechnic University of Tirana, Faculty of Geology and Mining, Rruga e Elbasanit, Tirana, Albania

*Corresponding author: andrea.uta@gmail.com

(Manuscript submitted in September 2024; accepted for publication in November 2024)

ABSTRACT

In order to decipher the paleo-depositional environments and the geodynamic evolution of Mirdita geological zone during the Upper Jurassic – Lower Cretaceous and implicitly the depositional time of the ophiolitic subjacent deposits, several areas with different sedimentary patterns were selected: external sedimentary facies of Upper Jurassic – Lower Cretaceous (Upper Berrisian – Lower Valanginian) and internal sedimentary facies of Upper Barremian – Lower Aptian, which were analyzed in detail from micropaleontological and sedimentological point of view. On the basis of micropaleontological and microfacies analysis, 3 facies zones were identified and subsequently divided into microfacies types, which vary from supratidal, intertidal (restrictive) to intertidal (open lagoon). The described microfacies are bioclastic mudstone, fenestral packstone and wackestone, bioclastic packstone and wackestone, while the micropaleontological assemblage indicates a Lower Aptian age, respectively the Bedoulian sub-stage.

Keywords: Mychasi, Hasi, Lower Aptian, Bedoulian, microfacies, microfauna, foraminiferaminifera.

INTRODUCTION

Cretaceous deposits are widespread within Mirdita geological zone from north to south, where in Has region (Pashtriku Mountain) they form a large massif with continuity on the territory of Republic of Kosovo. Further southwest are found the Cretaceous deposits of Mali i Shenjte, which constitute one of the largest and thickest outcrops (Zepa, Deja), while in the region between Fani i Madh and Fani i Vogel rivers are lying the Cretaceous deposits of Munella, known especially for its magnificent beehive – shaped karst, located at an altitude of over 1700 m. The Cretaceous deposits from the middle course of Shkumbin river represents another large outcrop within the central regions of Mirdita geological zone. In the southern regions, the Cretaceous deposits are widespread in Voskopoja, Polena, Rehova and Radanji regions.

The study of the Cretaceous deposits alongside those of Jurassic – Cretaceous age is of great importance to understand the evolution of Mirdita geological zone (Fig. 1) after the closure of the ocean basin with the same name. Fortunately, Albania offers great geological opportunities and various Albanian geologists and researchers (Arkaxhiu 1987; Peza 1983, 1985, 1989, Bushi & Arkaxhiu 1971; Peza et al. 1981, 1983, 1988; Dodona 1982, 1984; Marku 2000, 2002; Shehu et al. 1981, 1990; Xhomo et al. 2002, 2005) have carried out important studies that have greatly increased the geological knowledge of these deposits. Even some foreign geologists from the last century to the present have also studied the Cretaceous of Mirdita zone (Nowack 1929, Schlagintweit et al. 2006, 2008, 2012). The sedimentary deposits of this age are characterized by a small deformation appearing either as large monocli-

¹IGJEO, ²FGJM, Tirana
Email: andrea.uta@gmail.com

nal structures (Pashtriku Mountain), or as low brachysyncline structures of large dimensions (Munella, Mali i Shenjte, Polis, Radanji).

The data presented in this paper offer new important information that requires further studies that will lead to new interpretations, different from the traditional ones, especially those regarding the formational boundaries between the Jurassic – Cretaceous and Cretaceous

deposits. It is generally accepted by most geologists that the Cretaceous deposits are transgressively settling above underlying Barremian – Aptian conglomerate formations and the youngest on those conglomerates. The data from these stratigraphic sections carried out in Munella and Mali i Shenjte mountains testify to a rather different geological situation but they will be the subject of a future publication.




Figure 1. Albanian Geological map with tectonic zones and section of the Albanides (after Muceku et al. 2008).

Many studies were also focused on the Urganian deposits from this area (Peza 1983, 1985, 1989; Peza et al. 1981, 1983, 1985, 1988; Dodona 1982, 1984, Schlangintweit et al. 2006, 2009) and, therefore, our main aim was to describe the main types of microfacies, the identification of taxons with biostratigraphic significance and to have an exact paleoenvironmental reconstruction.

In most localities along Mirdita geological zone, the Early Cretaceous sedimentary succession consists of typical shallow carbonate deposits, whose environments were widely colonized by almost exclusively benthic microfaunal assemblages (mainly foraminifera and calcareous algae). Therefore, in the absence of organisms typical of open marine environments (e.g. ammonites, planktonic foraminifera), which are commonly used in high-resolution biostratigraphy, benthic foraminifera and calcareous algae play a major role in the chronological dating of the geological evolution of the study area.

The Lower Cretaceous deposits do not include the Berriasian – Valanginian levels, because in the literature are were not separated from the Upper Tithonian deposits. Usually, different levels of Lower Cretaceous deposits transgressively lie over older rocks and according to the studies carried out so far, the lowest levels of Barremian – Aptian are found above the Tithonian – Valanginian deposits (Krej – Lure, Shëngjin, Kurbnesh, Babje) or above the ophiolitic rocks (Qafë Komi, Kumbull, Vilan, Liqeni i Kuq, Farret, Bishnica – Voskop, Kamënë, Radanj). In Krej – Lura they are located through a bauxite horizon on the predominantly carbonate facies of Tithonian – Valanginian age (Peza et al. 1983).

According to the studies carried out in Kukes region, the Barremian – Aptian carbonate deposits contain the weathering core of ultrabasic rocks as well as intercalations (5 – 35 m) of red siliceous clays with ophiolitic sandstones, red clays and calcareous marls (Peza et al. 1989).

During the Aptian and Albian, the Lower Cretaceous basin expanded further, especially northeastward within Krumë – Surroj region and a carbonate sedimentation rich in obololids and occasionally in charophytes, predominates everywhere, while in Pashtrik and Domen mountains are present some rare levels with siliceous lenses.

GEOLOGICAL SETTING

The Myçhasi stratigraphic section is located near the village of Myçhas (Fig. 2), only tens of meters above the village houses. First of all, we note that the Cretaceous deposits of Hasi represent one of the largest Cretaceous outcrops within Mirdita zone. An important part of these deposits also continues within the territory of Republic of Kosovo. In Myçhas we are dealing with the lowest part of Hasi Cretaceous sedimentary succession, which is documented by the carbonate monoclinical structure with a continuous dip towards the east. The basal part of these Cretaceous deposits is represented by ultrabasic rocks followed by sequence of about 20 m of Fe - Ni laterites, limited horizon of conglobreccia (4 – 5 m) and the shallow-water carbonate deposits. There were sampled a total number of 90 samples from a thickness of 300 m.




Figure 2. Geology of the investigated area near Hasi (redrawn and modified after Xhomo et al. 2005).

METHODOLOGY

During the fieldwork, the selected stratigraphic section was examined and interpreted in relation to its lithology, microfacies and faunal content with a hand – held magnifying glass and from which a number of 90 samples were collected. During the laboratory studies, detailed micropaleontological and microfacies analyses were carried out, for which over a number of 100 thin section was made. The micropaleontological analyses were carried out by investigating the morphology of individuals (mainly foraminifera, calcareous algae and other micro- or macro-organisms), the specimens were photographed and the individuals belonging to each species were classified according to the taxonomic hierarchy. Then, the identification and classification of the foraminifera and other organisms was carried out, using their stratigraphic distributions. Microfacies analyses of these samples were performed by examining each sample based on its textural properties, (i.e., abundance and types of allochems and background mate-

rial) and vertical changes in microfacies type and micropaleontological content are used in interpreting the evolution of the carbonate deposits in question.

RESULTS AND DISCUSSIONS

Below we will present a detailed description of a number of 100 samples systematically collected throughout the stratigraphic section, defining and describing the microfacies and their micropaleontological associations mainly by identifying benthic foraminifera, extremely well represented in this section, as well as other more or less important micro- and macroorganisms.

Bioclastic wackestone

This microfacies is characterized by the presence of benthic foraminifera mainly represented by small miliolids, where species with thin tests, such as *Istriloculina elliptica* (Pl. 6: fig. 95), and *Istriloculina* sp. (Pl. 6: figs. 106 – 110) are well represented and accompanied by *Glomospira urgioniana* (Pl. 6: figs. 96 – 105),

Glomospira sp., *Chofatella decipiens* (Pl. 1: fig. 18), *Praechrysalidina infracretacea*, *Mayncina bulgarica* (Pl. 1: fig. 2), *Charentia cuvillieri* (Pl. 1: figs. 3 – 4), *Everticyclammina* sp. (Pl. 1: fig. 17), *Bolivinopsis labelosa* (Pl. 3: fig. 18), *Sabaudia minuta*, *Melathrokerion* sp., *Amobaculites* sp., *Arenobulimina* sp., *Conorboides* sp., *Novalesia* sp. (Pl. 2: figs. 35 – 36; Pl. 3: fig. 37), *Reophax* sp., *Spiroloculina* sp., *Quinqueloculina* sp., *Cayeuxia* sp., *Salpingoporella muehlbergii* (Pl. 7: fig. 119), various textulariids and ostracod fragments. We remark the apparition of the calcareous alga *Salpingoporella dinarica* (Pl. 7: fig. 118) which will be present within a significant part of our stratigraphic section and in some cases represent the dominant microfacies. The microfacies is crossed by fissures and voids of various sizes, shapes and orientations and is quite porous.

Bioclastic wackestone-packestone

This microfacies contains various benthic foraminifera such as *Debarina hahounerensis* (Pl. 1: fig. 8), *Mayncina bulgarica* (Pl. 1: figs. 7, 9, 10, 12, 13), *Ammobaculoides ? aff plumerae* (Pl. 3: fig. 41), *Bolivinopsis* sp., *Arenobulimina* sp. (Pl. 2: figs. 25, 27, 33), *Dobrogeлина? cartusiana* (Pl. 2: figs. 28 – 29, 32), *Dobrogeлина* sp. (Pl. 2: fig. 60), *Belorussiella* sp. (Pl. 3: fig. 52), *Pseudotextulariella* sp. (Pl. 3: fig. 40), *Chofatella decipiens*, *Sabaudia minuta*, *Istriloculina* sp., *Quinqueloculina* sp., *Glomospira* sp., *Valvulineria* sp., *Bolivinopsis* sp. (Pl. 3: fig. 38), *Rivularia* sp. and fragments of ostracods. The microfacies is crossed by fissures of different sizes and orientations and by geopetal structures filled with fine silty sediment with a ferruginous pigment. This microfacies is also characterized by the presence of fenestral structures where fenestrae may consist of open cavities or voids completely or partially filled with a vadose silt sediment or diagenetic products (silt with iron oxides or cement). The fenestral and geopetal structures show different

morphologies: elliptical, with an oval or irregular base or an irregular upper shape, while their sizes vary from millimetric to submillimetric and are filled with vadose silt or skeletal and peloidal grains. This type of microfacies is quite scarce in microfossils and occasionally it may contain fragments of rudists.

Peloidal oncolithic wackestone – packestone with oncolithized *Cayeuxia* sp. cyanobacteria

This type of microfacies is quite porous.

Bioclastic wackestone with small rudists

The rudists are small forms of *Mathesia darderi*, which are very typical for the Upper Barremian – Lower Aptian deposits, until now described only from Spain and Bulgaria by Masse and Fenerci-Masse (2010, 2011). In the micritic matrix rare foraminifera such as *Istriloculina* sp., *Quinqueloculina* sp., *Sabaudia minuta*, *Valvulineria* sp., *Charentia cuvillieri* are present. We identified the same level as *Mathesia darderi* in the Shenjti 2, Laramani and Shengjini stratigraphic section (Uta 2021).

Fine bioclastic wackestone

This fine grained microfacies contains a microfauna represented by foraminifera as *Chofatella decipiens*, *Charentia cuvillieri*, *Sabaudia minuta*, *Istriloculina* sp. (Pl. 6: fig. 110; Pl. 7: fig. 113), *Bolivinopsis* sp., *Arenobulimina* sp., the algae *Salpingoporella dinarica* and ostracod fragments.

Bioclastic wackestone with *Salpingoporella dinarica*

This microfacies is characterized by the abundant presence of *Salpingoporella dinarica* and benthic foraminifera such as *Praechrysalidina infracretacea*, *Charentia cuvillieri*, *Charentia* sp., *Sabaudia minuta*, *Istriloculina* sp., *Quinqueloculina robusta* (Pl.

7: fig. 112), *Quinqueloculina* sp. (Pl. 7: figs. 111, 114), *Glomospira urgoni-ana*, *Glomospira* sp., *Valvulineria* sp., *Conorboides* sp., *Gaudryina* sp. and ostracods. The microfacies is characterized by the presence of geopetal structures and the appearance of very fine fissures.

Peloidal bioclastic wackestone-packestone

This type of microfacies is very rich in benthic foraminifera such as *Chofatella decipiens*, *Charentia cuvillieri*, *Pfenderina aureliae*, *Glomospira* sp., *Istriloculina* sp., *Quinqueloculina* sp., *Textularia* sp., *Valvulineria* sp., *Gaudryina* sp., *Arenobulimina* sp., *Earlandia* sp., the algae *Salpingoporella dinarica* (Pl. 7: figs. 120 – 121, 126), *Cayeuxia* sp. type cyanobacteria, gastropods and crinoid fragments.

Intraclastic-bioclastic mudstone

This microfacies contains foraminifera as *Mayncina bulgarica*, *Chofatella decipiens*, *Debarina hahounerensis*, *Pfenderina aureliae*, *Sabaudia minuta*, *Sabaudia* sp., *Pseudocyclamina lituus* (Pl. 2: fig. 19), *Everticyclammina* sp. (Pl. 2: figs. 20 – 23), *Quinqueloculina* sp., *Valvulineria* sp., *Bolivinopsis* sp. (Pl. 3: figs. 42 – 45), *Glomospira* sp. and micritic intraclasts.

Mudstone wackestone with *Istriloculina* sp.

Here the microfauna is very scarce being represented only by a few specimens of *Istriloculina* sp. and fragments of gastropods or is almost absent.

Bioclastic wackestone with miliolids and *Istriloculina* sp.

The miliolids are the dominant microfauna and the microfacies contain voids filled with very fine-grained sediment. With the sample H46, an important diversification in the size of microfauna is noted, such as in

the miliolids, with the appearance of large miliolids along with the appearance of orbitolinids.

Bioclastic wackestone

This microfacies contains *Sabaudia minuta*, large miliolids such as *Quinqueloculina* sp. characterized by the presence of moldic porosity, *Dervetina* sp. (Pl. 7: figs. 115, 117), *Rumanoloculina* sp., *Mayncina bulgarica*, *Vercorsella scarsellai*, *Vercorsella arenata* (Pl. 4: figs. 66 – 67; Pl. 5: figs. 77, 82), *Vercorsella* sp. (Pl. 4: figs. 65, 68; Pl. 5: figs. 79 – 80), *Cuneolina parva* (Pl. 4: figs. 56 – 57; Pl. 5: fig. 86), *Nautiloculina cretacea*, *Melathokerion valserinensis*, *Pfenderina globosa*, *Pfenderina aureliae*, *Pseudocyclamina lituus*, *Charentia cuvillieri* (Pl. 1: figs. 6, 11, 14 – 15), *Sabaudia minuta* (Pl. 4: figs. 58 – 59, 70, 72 – 74; Pl. 5: fig. 75), *Sabaudia capitata* (Pl. 4: figs. 61 – 64, 69, 71; Pl. 5: figs. 76, 78, 81, 83 – 85), *Rumanoloculina* sp., *Glomospira urgoni-ana*, *Textularia* sp., *Valvulineria* sp., *Novalesia* sp., *Gaudryina* sp., *Rivularia* sp. and fragments of gastropods, rudists or echinoderms. The sample H52 marks the appearance of orbitolinid foraminifera. Bioturbation traces are occasionally observed (sample H69a).

Bioclastic wackestone with small rudists and bioclastic wackestone packestones are also present.

Mudstone-wackestone with charophytes

This microfacies contains cyanobacteria such as *Rivularia*-type cyanobacteria (Pl. 7: figs. 127 – 128) and *Girvanella* sp. (Pl. 7: figs. 122 – 123), *Istriloculina* sp., charophytes (Pl. 7: figs. 124 – 125) and geopetal structures being a microfacies typical of restrictive environments.

Bioclastic-oncolithic wackestone-packestone

This microfacies is characterized by

the presence of orbitolinids such as: *Mesorbitolina texana* (Pl. 5: fig. 90), *Paleodictyoconus arabicus* (Pl. 5: figs. 87, 89, 92; Pl. 6: figs. 93 – 94), *Paracoskinolina* sp. (Pl. 5: fig. 88), *Orbitolina* sp., large miliolids, *Charentia cuvillieri*, *Chofatella decipiens*, *Pseudocyclammina lituus*, *Andersenia rumana*, *Sabaudia minuta*, *Cuneolina* sp., *Novalesia* sp., *Istriloculina* sp., *Glomospira* sp., large and small forms of *Arenobulimina* sp., *Bolivinopsis* sp. (Pl. 3: figs. 47 – 55), *Textularia* sp. and *Valvulineria* sp.

Other microfacies are mudstone-wackestone with orbitolinids and fenestrated mudstone

The distribution of benthic fauna, especially foraminifera, calcareous algae and macro-organisms, is strongly controlled by local ecological conditions. Foraminifera in particular are important biostratigraphic tools because they are usually rapidly evolving, they are abundant and widespread, and species or groups of species often disappear quite suddenly (Hallock 1982). Therefore, many species can be used for local or even regional correlations. In the absence of ammonites and planktonic foraminifera, i.e. organisms known for their high – resolution stratigraphic value, the age determinations of the Upper Barremian – Lower Aptian carbonate deposits of Myćhasi stratigraphic section are typically based on benthic organisms, such as foraminifera and calcareous algae. These organisms are usually biostratigraphically calibrated with those localities of the Tethys area, where similar benthic associations are found in association with ammonites or planktonic foraminifera. Below, we will note the main species of benthic foraminifera and calcareous algae typical for the Barremian – Aptian interval of the study area with the aim to clarify their biostratigraphic positions and summarize the main results of the discussion with emphasis on data from the Mirdita carbonate platform.

In the Myćhas stratigraphic section, *Palorbitolina lenticularis*, the most common and biostratigraphically important orbitolinid foraminifer, is known from numerous localities of Lower Aptian age. The abundant *Salpingoporella dinarica* is a well – known alga that frequently and abundantly occurs throughout the Mediterranean. Although it was also described from older deposits (Radcoic 1967; Sokac 1996), it is most common from the Upper Barremian to the end of the Aptian.

Regarding the Aptian biostratigraphy, some authors use a bipartite division (Bedoulian = Early, Gargasian + Clansayesian = Late Aptian) (Schroeder et al. 2010) while others authors prefer a tripartite division (Bedoulian = Early, Gargasian = Middle, Clansayesian = Late Aptian) (Castro et al. 2002; Gradstein et al. 2004). Masse (2003) also distinguished a Lower Bedoulian?/Early (ammonite zone of *Deshayesites* + *D. weissii*) and an Upper Bedoulian?/Late (ammonite zones with *D. deshayesi* and *Dufrenoya furcata*). The biostratigraphy of the study section is based on benthic foraminifera and supporting data coming from algae and other benthic foraminifera.

A very important species is *Mesorbitolina texana*, identified by Gawlick (2008) in the upper part of Mali i Shenjte stratigraphic section and it was described by Schroeder (1964) from the Urganian of Spain. Through other works, this age was corrected, assigning the first appearance of *Reophax giganteus* to the lower Early Aptian (Cherchi & Schroeder 1999; Schroeder et al. 2002; Schroeder et al. 2010). The occurrence of this taxon should be restricted to the lowermost part of the Early Aptian (Bedoulian) (Schroeder 1964; Schroeder et al. 2010). This species was also identified in our section.

Reviewing the literature, Masse (2003) concluded that *Reophax giganteus* is a marker for Bedoulian

and that the data from Spain suggest a Lower/Early Bedoulian age. The biostratigraphic distribution of *Mesorbitolina texana* often indicates an Upper Aptian (= Clansayesian) to middle Albian age (Schroeder 1975, 1985; Velić 2007). A comprehensive analysis of different sections from Spain, sections containing orbitolinids, planktonic foraminifera and ammonites (Castro et al. 2002) has shown that *Mesorbitolina texana* reaches the Upper Gargasian within the zone with the planktonic foraminifer *Globigerinelloides algerianus* (= upper part of the ammonite zone with *Parahoplites melchioris*, Ropolo et al. 2008). In a new biostratigraphic scheme of the Barremian – Albian orbitolinids, the first occurrence of *Mesorbitolina texana* is regarded as Middle Gargasian (the base of the ammonite zone with *P. melchioris*) (Schroeder et al. 2010).

During this study we have tried to identify the maximum number of organisms up to the species level and in addition, some taxa were not assigned up to the species level, but they have been identified only up to the genus level.

Briefly, we present below some taxa of biostratigraphic importance for the Barremian – Aptian age: *Charentia cuvillieri*, Neumann 1965 (Biostratigraphic distribution: Hauterivian – Cenomanian of the Mediterranean Tethys), *Choffatella decipiens*, Schlumberger 1905 (Biostratigraphic distribution: Hauterivian – Aptian), *Debarina hahounerensis* Fourcade, Raoul et Vila 1972 (Biostratigraphic distribution: Upper Barremian – Aptian), *Glomospira urgoniana* Arnaud-Vanneau 1980 (Biostratigraphic distribution: Barremian – Aptian), *Istriloculina elliptica* Iovcheva 1962 (Biostratigraphic distribution: Barremian – Lower Aptian; was originally described from the Aptian of Bulgaria and has been recorded along the Tethys margin; Arnaud-Vanneau & Sliter 1995), *Palorbitolina lenticularis* Blumenbach 1805 (Biostratigraphic

distribution: Late Barremian – Early Aptian; is widespread in the Tethys zone), *Pfenderina aureliae* Neagu 1979 (Biostratigraphic distribution: Upper Barremian – Lowest Aptian), *Praechrysalidina infracretacea* Luperto Sinni 1979 (Biostratigraphic distribution: Late Barremian – Early Aptian), *Melathrokerion valserinensis* Brönnimann & Conrad 1967 (Biostratigraphic distribution: Barremian – Early Aptian).

The described microfauna, such as orbitolinids, other index forms and also the association of *Salpingoporella dinarica* – *Chofatella decipiens* or *Salpingoporella dinarica* – *Praechrysalidina infracretacea* are for the Lower Aptian, Bedoulian substage.

Paleoecological considerations

Three facies zones have been identified and divided into several types of microfacies, which vary from supratidal, intertidal (limited, restrictive) and intertidal (open lagoon). The defined microfacies are bioclastic mudstone, fenestral packstone and wackestone, bioclastic wackestone and packstone.

In the studied stratigraphic section, the abundant presence of genera such as *Chofatella*, *Melathrokerion*, *Sabaudia*, *Vercorsella* or orbitolinid foraminifera along with forms typical of limited/restrictive environments such as *Istriloculina* and *Glomospira* and the textural interpretation of the dominant facies (wackestone – packstone) denote a calm environment, typical of the inner environments of Lower Cretaceous carbonate platforms.

Salpingoporella dinarica is a species highly tolerant of fluctuations in environmental factors, as shown by the fact that it thrives in low – energy and restrictive environments. Facies such as those described in the Mychasi represented by algal wackestones with *Salpingoporella dinarica*, are very typical facies of limited/restrictive

tive environments that characterized the carbonate platforms of Aptian age. Their association with ostracods, charophytes and foraminifera typical of these environments such as *Istriloculina* and *Glomospira*, which are abundant in our stratigraphic section, shows the existence of *brakish* water ponds typical of highly protected lagoons.

The lifestyle of foraminifera described in these sedimentary environments is dominated by epifaunal forms (*Glomospira* sp., *Quinqueloculina* sp., *Lenticulina* sp., *Charentia* sp., *Nezzazata* sp., *Haplophragmoides* sp., *Istriloculina* sp., *Pseudocyclamina* sp.), then by infaunal forms (*Gaudryina* sp., *Pseudolituonella* sp., *Praechrysalidina* sp., *Bolivinopsis* sp., *Ammobaculites* sp., *Haplophragmoides* sp.). Foraminiferal assemblages, dominated by epifaunal and infaunal forms with agglutinated test such as *Pseudocyclamina lituus* or *Everticyclamina* sp. or with calcitic test, are in concordance with a high content of nutrients existing in the sediments, as well as with a low oxygen level (Reolid et al. 2008). Mud – digging forms such as *Istriloculina* sp. and *Glomospira* sp. are mainly present in the muddy and limited/restrictive facies, very typical of the depositional environments described in Myçhas stratigraphic section.

The ostracods described in the above sections indicate near-coastal environments with a wide range of temperature and salinity fluctuations.

CONCLUSIONS

On the basis of micropaleontological and microfacies analysis, 3 facies zones were identified and subsequently divided into microfacies types which vary from supratidal, intertidal (restrictive), intertidal (open lagoon). The described microfacies are bioclastic mudstone, fenestral packstone and wackestone, bioclastic packstone and wackestone, while the micropaleontological assemblage indicates a Lower Aptian age, Bedulian. In Myçhas, the Lower Cretaceous carbonate deposits are lying above the Fe-Ni lateritic deposits and ultrabasic mantle formations and further east are followed by increasingly younger deposits. In the territory of Kosovo, in the Has province, the age of the Cretaceous carbonate deposits is Senonian. Thus, the age of the Cretaceous deposits extending over the ophiolites and their primary cover is older in the central parts of the Mirdita zone and is increasingly newer towards the east-northeast.

Acknowledgements

We thank Professor Dr. Avni Meshi for the valuable information regarding the stratigraphic section of Myçhas.

REFERENCE

- ARKAXHIU F. (1981).** EVOLUCIONI PALEOGJEOGRAFIK DHE KUSHTET E FORMIMIT TË PRODHIMEVE TË TJETËRIMIT (LAT-ERITIK) NË RAJONIN LIBRAZHD-POGRADEC. *BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, NR. 1, TIRANË.
- BUSHI E. & ARKAXHIU F. (1971).** TË DHËNA MBI NDËRTIMIN GJEOLGO – STRUKTUROR TË ZONËS BUSHTRICË-PRRENJAS E BERZESHË. *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, NR. 4, TIRANË.
- CASTRO J.M., COMPANY M., DE GEA G.A. & AGUADO R. (2001).** BIOSTRATIGRAPHY OF THE APTIAN – MIDDLE CENOMANIAN PLATFORM TO BASIN DOMAIN IN THE PREBETIC ZONE OF ALICANTE, SE SPAIN: CALIBRATION BETWEEN SHALLOW WATER BENTHONIC AND PELAGIC SCALES. *CRETACEOUS RESEARCH*, 22, 145-156. DOI: 10.1006/CRES.2000.0249
- CERCHI A. & SCHROEDER R. (1999).** *MONTSECIELLA*, A NEW ORBITO-LINID GENUS (FORAMINIFERIDA) FROM THE UPPERMOST HAUTERIVIAN – EARLY BARREMIAN. *TREB. MUS. GEOL. BARCELONA*, 8, 5–23.
- DODONA E. (1982)** STRATIGRAFIA, MIKROFACIET DHE MIKROFAUNA E ZONES MIRDITA. DISERTACION.
- HALLOCK P. (1982).** EVOLUTION AND EXTINCTION IN LARGER FORAMINIFERA. *MARINE SCIENCE FACULTY PUBLICATIONS*, FQ. 1229.
- MARKU D. (2000).** MBI TRANSGRESIONIN E BAREMIANIT NË RAJONIN E MUNELLËS (ZONA MIRDITA QËNDRORE) DHE NDRYSHIMIN E SKENËS STRATIGRAFIKE. *KONGRESI I 8-TE SHQIPTAR I GJEO SHKENCAVE*, FQ. 104.
- MARKU D. (2002).** RAPORT SHKENCOR I PROJEKTIT V-1b “KRETAKU I RAJONIT ZEPEGURI I NUSES” (REPORT OF THE PROJECT V1b CRETACEOUS OF THE ZEPE-GURI I NUSES AREA). *ARKIVI QENDROR TEKNIK I GJEOLOGJISË, SHËRBIMI GJEOLOGJIK SHQIPTAR*, FQ. 62.
- MASSE J.-P. (2003).** INTEGRATED STRATIGRAPHY OF THE LOWER APTIAN AND APPLICATIONS TO CARBONATE PLATFORMS: A STATE OF THE ART.– IN: GILI, H.N. & SKELTON, P.W. (EDS.): NORTH AFRICAN CRETACEOUS CARBONATE PLATFORM SYSTEMS, NATO SCIENCE SERIES, IV. *EARTH AND ENVIRONMENTAL SCIENCES, KLUWER ACADEMIC PUBLISHERS*, 28, 215–227.
- NOWACK E. (1929).** GEOLOGISCHE UBERSCHIFT VON ALBANIAN. ERLANTERUNG ZUR GEOLOGISCHEN KARTA 1:200000, SALZBURG.
- PEZA L.H., XHOMO A. & THEODHORI P. (1973).** STRATIGRAFIA E DEPOZITIMEVE MEZOZOIKE TË ZONËS SË ALPEVE SHQIPTARE. *GEOFOND ISPGJ TIRANA*, FQ. 377 (UNPUBLISHED REPORT).
- PEZA L.H. (1981).** STRATIGRAFIA E DEPOZITIMEVE KRETAKE TË ZONËS SË ALPEVE SHQIPTARE DHE STUDIMI MONOGRAFIK I DISA MOLLUSQEVE. UNPUBLISHED PH.D. THESIS, FQ. 155, PL. 1-11, TIRANË.
- PEZA L.H., MARKU D. & PIRDENI A. (1981).** BIOSTRATIGRAFIA DHE PALEOGJEOGRAFIA E DEPOZITIMEVE KRETAKE TË RAJONIT TË MUNELLËS. *PËRMBLEDHJE STUDIMESH*, 2, 95-108.
- PEZA L.H., PIRDENI A. & TOSKA Z. (1983).** CRETACEOUS DEPOSITS AT KURBNESH – KREJLURA REGION AND DATA ON PALEOGEOGRAPHICAL DEVELOPMENT OF THE MIRDITA ZONE DURING UPPER JURASSIC – CRETACEOUS. *BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, 4, 71-90.
- PEZA L.H. & GARORI R. (1985).** STRATIGRAFIA E DEPOZITIMEVE KRETAKE TË ZONËS MIRDITA DHE PREMISAT PËR KËRKIMIN E MINERALIZIMEVE, QË LIDHEN ME TO. *GEO FOND ISPGJM* (UNPUBLISHED REPORT).
- PEZA L.H., JANI P., PETRO TH., THEODHORI P., PIRDENI A. & GARORI R. (1985).** DEPOTS DU TRIAS SUPERIEUR CLANS LA REGION DE ZEMBLAK (KORCE). *BULETIN I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, 4, 59-63.
- PEZA L.H. (1988).** *CRETACEOUS OF THE MIRDITA ZONE AND ITS MACRO FAUNA. UNPUBLISHED D. SC. THESIS VOL. I - GEOLOGY, FQ. 150, VOL. II - PALEONTOLOGY, FQ. 376, PL. L-76, TIRANA.*
- PEZA L.H. (1989).** A NEW NERINEID SPECIES (GASTROPODA): *TROCHOPTYGMATIS VINNJOLLENSIS* NOV. SP., FROM BARREMIAN-APTIAN DEPOSITS OF VINNJOLL (BMTEL). *BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, 2, 127-133, PL. L.
- PEZA L.H., SHKUPI D., TURKU I. & TEROLLI I. (1990).** GEOLOGY OF VERMOSHI REGION. *BULETINI I SHKENCAVE GJEOLGJIKE*, 4, 39-55.
- PEZA L.H. & ZITT J. (2002).** URGONIAN (EARLY CRETACEOUS) ECHINOIDS OF THE MIRDITA ZONE (SOUTHEAST ALBANIA). *GEOLOGICA CARPATHICA*, 53/5, 327-332.
- PRELA M. (1994).** MIRDITA OPHIOLITE PROJECT: 1. RADIOLARIAN BIOSTRATIGRAPHY OF THE SEDIMENTARY COVER OF THE OPHIOLITES IN THE MIRDITA AREA (ALBANIA): INITIAL DATA. *OFIOLITI*, 9, 279-86.
- PRELA M., CHIARI M. & MARCUCCI M. (2000).** JURASSIC RADIOLARIAN BIOSTRATIGRAPHY OF THE SEDIMENTARY COVER OF OPHIOLITES IN THE MIRDITA AREA, ALBANIA: NEW DATA. *OFIOLITI*, 25(1), 55-62.
- REOLID M., RODRÍGUEZ-TOVAR F.J., NAGY J. & OLÓRIZ F. (2008).** BENTHIC FORAMINIFERAL MORPHOGROUPS OF MID TO OUTER SHELF ENVIRONMENTS OF THE LATE JURASSIC (PREBETIC ZONE, SOUTHERN SPAIN): CHARACTERIZATION OF BIOFACIES AND ENVIRONMENTAL SIGNIFICANCE. *PALAEOGEOGRAPHY, PALAEO- CLIMATOLOGY, PALAEOECOLOG*, 261, 280-299.

- ROPOLO P., CONTE G., MOULLADE M., TRONCHETTI G. & GONNET R. (2008).** THE DOUVILLEICERATIDAE (AMMONOIDEA) OF THE LOWER APTIAN HISTORICAL STRATOTYPE AREA AT CASSIS-LE BÉDOULE (SEFRANCE). *CARNETS DE GÉOLOGIE MEM.*, 3 (CG2008_M03).
- SCHLAGINTWEIT F., GAWLICK H.-J., LEIN R. & HOXHA L. (2012).** ONSET OF AN APTIAN CARBONATE PLATFORM, OVERLAYING A MIDDLE-LATE JURASSIC RADIOLARITIC-OPHIOLITIC MÉLANGE IN THE MIRDITA ZONE OF ALBANIA. *GEOLOGIA CROATICA*, 65/1, 29-40.
- SCHLAGINTWEIT F., GAWLICK H.-J., MISSONI S., LEIN R. & HOXHA L. (2006).** LATE JURASSIC TO EARLY CRETACEOUS DASYCLADALES AND BENTHONIC FORAMINIFERA FROM THE MUNELLA CARBONATE PLATFORM S.L. OF THE MIRDITA ZONE. *XIII-TH CONGRESS OF CARPATIAN-BALCAN GEOLOGICAL ASSOCIATION*, FQ. 527-530.
- SCHLAGINTWEIT F., GAWLICK H.-J., MISSONI S., HOXHA L., LEIN R. & FRISCH W. (2008).** THE ERODED LATE JURASSIC KURBNESH CARBONATE PLATFORM IN THE MIRDITA OPHIOLITE ZONE OF ALBANIA AND ITS BEARING ON THE JURASSIC OROGENY OF THE NEOTETHYS REALM. *SWISS J GEOSCI*, 101, 125-138.
- SCHROEDER R. (1964).** ORBITOLINIDEN-BIOSTRATIGRAPHIE DES URGONSNORDÖSTLICH VON TERUEL (SPANIEN). *N. JB. GEOL. PALÄONT. MH.*, 462-472.
- SCHROEDER R. (1975).** GENERAL EVOLUTIONARY TRENDS IN ORBITOLINAS. *REV. ESP. MICROPALÉONT.*, NUM. SPEC., 117-128.
- SCHROEDER R. (1985).** *ORBITOLINA (M.) TEXANA* (ROEMER, 1849) – IN: SCHROEDER R. & NEUMANN M. (EDS.): LES GRANDS FORAMINIFÈRES DU CRÉTACÉ MOYEN DE LA RÉGION MÉDITERRANÉENNE. *GÉO-BIOS MÉM. SPÉC.*, 7, 77-80.
- SCHROEDER R., CLAVEL B., CHERCHI A., BUSNARDO R., CHAROLLAIS J. & DECROUZÉ D. (2002).** LIGNÉES PHYLÉTIQUES D'ORBITOLINIDÉS DE L'INTERVALLE HAUTERIVIEN SUPÉRIEUR – APTIEN INFÉRIEUR; LEUR IMPORTANCE STRATIGRAPHIQUE. *REV. PALÉOBIOL.*, 21, 853-863.
- SCHROEDER R., VAN BUCHEM F.S.P., CHERCHI A., BAGHBANI D., VINCENT B., IMMENHAUSER A. & GRANIER B. (2010).** REVISED ORBITOLINID BIOSTRATIGRAPHIC ZONATION FOR THE BARREMIAN – APTIAN OF THE EASTERN ARABIAN PLATE AND IMPLICATIONS FOR REGIONAL STRATIGRAPHIC CORRELATIONS. *GEOARABIA SPEC. PUB.*, 4, 49-96.
- SHEHU R. ET AL. (1990).** GJELOGJIA E SHQIPËRISE. *SHGJSH*, FQ. 306.
- UTA A. (2021).** MIKROPALÉONTOLOGIA, MIKROFACIET DHE PALEOMJEDISET SEDIMENTARE TE DEPOZITIMEVE KARBONATIKE ME MOSHE KRETAK I POSHTEM TE ZONES GJELOGJIKE MIRDITA DHE MARREDHENJET E TYRE ME FORMACIONET E POSHTESHTRUARA. FQ. 183 (DOKTORATURE E PABOTUAR).
- VELIC I. (2007).** STRATIGRAPHY AND PALAEOBIOGEOGRAPHY OF MESOZOIC BENTHIC FORAMINIFERA OF THE KARST DINARIDES (SE EUROPE). *GEOLOGIA CROATICA*, 60, 1-113.
- XHOMO A., KODRA A., XHAFA Z. & SHALLO M. (2002).** GJELOGJIA E SHQIPËRISË. *SHGJSH*, TIRANE, FQ. 404.
- XHOMO A., KODRA A., XHAFA Z. & SHALLO M. (2005).** HARTA GJELOGJIKE E SHQIPËRISË NË SHKALLËN 1:200 000. *SHGJSH*, TIRANË.

PLATE 1




PLATE 2



PLATE 3




PLATE 4




PLATE 5




PLATE 6





PLATE 7



MINERALIZIME HIDROTERMALE – TELETERMALE NË RAJONIN E DIBRËS DHE PROBLEME TË PERSPEKTIVËS SË KËRKIMEVE VESEL HOXHA^{1*} & ILIR ALLIU²

¹Instituti i Gjeoshkencave, Don Bosko Nr. 60, Tiranë, Shqipëri

²Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri

*Autor korrespondent: vesel.hoxha@gmail.com

(Dorëshkrim i dorëzuar në shtator 2023; i pranuar për botim në nëntor 2024)

ABSTRAKT

Mineralizimet e sqfurit në objektin e Kërçishtit të Sipërm, të shoqëruara nga ato të realgar - auripigmentit, dausonitit dhe mineralizimet e pjesës verilindore të Dibrës, kanë lidhje të dukshme, jo vetëm nga përbërja minerale por edhe ajo strukturore apo gjenetike. Në rajonin Kërçisht – Qafa e Rosnikut (rajoni i Dibrës), me një shtrirje të konsiderueshme rreth 50 km, hidrotermat kanë ndërprerë të gjithë formacionet nga moshat më të vjetra paleozoike e deri tek ato me të rejat, të Eocen - Oligocenit (?). Mineralizimi i prodhuar nga këto hidroterma takohet i lokalizuar kryesisht sipas linjave tektonike regjionale mbihipëse, atyre të rendeve më të ulëta si dhe pranë kontaktit me diapiret evaporitike. Shumica e këtyre mineralizimeve nga karakteristikat janë epigjenetike, hidrotermale-teletermale. Ky lloj mineralizimi është takuar në disa shfaqje të vendin tonë. Ai lidhet kryesisht me thyerjet tërthore si ajo Shkodër – Pejë, Tepelenë – Prespë dhe Vlorë – Elbasan – Dibër etj. Janë mineralizime hidrotermale (teletermale), të lidhura me një magmatizëm të ri paseocenik – oligocenik?, pa përjashtuar edhe faktin se një pjesë e shfaqjeve në fjalë mund të jenë atakuar më parë edhe nga një magmatizëm më i hershëm, kjo kryesisht për disa shfaqje që lokalizohen në Njësinë e Muhurr – Çajës dhe Malësisë së Korabit.

Fjalë kyçe: Mineralizime hidrotermale-teletermale, shfaqje të mineralizuara, sqfurar, ar, polimetale, linja tektonike.

HYRJE

Mineralizimet hidrotermale – teletermale i kemi vlerësuar si më kryesoret dhe më perspektivët e pjesës lindore të rajonit të Dibrës (Figs. 1, 2). Veç shfaqjes së njohur të Kërçishtit të Sipërm – Kllobçishtit, vite më parë e sidomos pas viteve 80’ të shekullit të kaluar, janë dokumentuar një sërë shfaqjesh të mineralizuara të natyrës hidrotermale në rajonet lindore e verilindore të Dibrës (Premti 1971; Kodra et al. 1986; Hoxha 2001, 2022; Hoxha et al. 2014). Karakteristikë e tyre është se këto shfaqje vendosen pothuajse në të dy anët e thyerjes tërthore të emërtuar Lushnje – Elbasan – Dibër (sipas Aliaj 1979, në Aliaj 2012) ose Vlorë – Elbasan – Dibër (Sulstarova et al. 2000). Mund të themi se objektet me mineralizime të kësaj natyre vetëm sa janë

gërvishur me punime kërkuese e vlerësuese, sidomos ato të takuara së fundmi. Brenda çdo tërthoreje, mund të konstatohet se mineralizimet e realgar – auripigmentit, si më të dukshmet e të qarta, kanë një zonalityet.

NDËRTIMI GJEOLOGJIK

Në grupin e shfaqjeve të kësaj natyre që vendosen në anët e thyerjes Vlorë – Elbasan – Dibër cilësojmë si vijon:

– Në pjesën perëndimore rreth Qarrihtës dhe Fushë – Studnës janë të zhvilluara aureolat e zhivës;

– Rreth zonës Kërçisht – Kllobçisht zhvillohet sqfuri nativ, realgar – auripigmenti dhe disa mineralizime të tjera;

– Më në veri, shfaqjet e Peshkopisë dhe Kastriotit në përruan e Llixhave, në përruan e Bahutajve dhe në Vrenjt, duke vijuar në Trojak, Dipjakë e Varin e Sejmenit të Šlovës, e më sipër në Malësinë e Korabit tek Stanet e Preshit, Qafën e Rritheve, Burimet e Izvirit, Kepin e Stogjit, shfaqjet në fillimin e Rrafshit të Korabit e deri tek Qafa e Rosnikut (Piramida nr. 2), apo mineralizimet e Avdanicës në Bjeshkën e Preshit, janë të zhvilluara jo vetëm mineralizimet e realgar – au-

ripigmentit, por në disa objekte, siç do të trajtojmë në vijim veçmas, janë takuar edhe shoqërimet të tjera si ato të arit, zhivës, bakrit, plumbit, zinkut, manganit, hekurit dhe elementeve të tjerë si V, Mo, Co etj.;

– Duke e ndjekur linjën e tërthores mineralizimet vazhdojnë edhe në Maqedoninë e Veriut, matanë Qafës së Rosnikut, deri në afërsi të Shkupit, me një zhvillim më të mirë të stibiumit etj. (Arsovski & Ivanov 1977).




Figura 1. Skemë tektonike e rajonit Kërçisht – Qafa e Rosnikut (sipas Melo 1982; Hoxha 2001).

Faktori kryesor i kontrollit dhe përqendrimit të mineralizimit mendojmë se janë prishjet tektonike dhe kryesisht planet e rrafsheve të mbihijëve. Mineralizimi vendoset në zonat tektonike që shoqërojnë ngritjet e diapirit të gipseve në tërë rajonin e përhapjes, si dhe në prishjet tektonike përgjatë mbihijjes së

Njësisë së Kollovozit mbi Njësinë e Muhurr Çajës dhe Malësisë së Korabit (Kodra & Hoxha 2019), mbihijëve të flishit Jurasiko – Kretak të Njësisë së Ostrenit (ose Krastës Lindore) mbi formimet e Eocen – Oligocenit (?) të Njësisë së Dibrës dhe prishjeve tektonike të rendeve më të vogla brenda njësisë tektonike (Hoxha et al. 2014).

Edhe në objektin e Kërçishtit të Sipërm mineralizimet kontrollohen nga prishjet tektonike që ndërpresin depozitimet nga Verfeniani e deri ato të Eocen – Oligocenit (?). Po ashtu, mineralizime të sulfureve të arsenikut janë takuar edhe në kontaktin e flishit të Eocen – Oligocenit (?) mbi gëlqerorët e Santonianit (Fig. 3).

Në tërësi, si mineralizime kryesore teletermale të temperaturave të ulëta, të moshave të reja, janë ato të realgar – auripigmentit, ku në tërësi përmbajtja e Arsenikut varion nga 4 – 5 deri ne 6 %, përmbajtje e rëndësishme edhe për përdorimin praktik. Nënvizojmë se, veç këtyre mineralizimeve, në objekte të ndryshme takohen edhe mineralizime të tjera. Kështu, në objektin e Kërçishtit të Sipërm, një rëndësi të veçantë merr mineralizimi i squfurit të vetëlindur, që përbën një fazë të caktuar të hidrotermës dhe që vendoset mbi karstin e gëlqerorëve në dy tre horizonte paralele të ekranizuar nga dolomitet.

Kjo fazë mineralizimi mendohet më e hershme se faza e formimit të arsenikut, që përbën një fazë të mëvonshme dhe që vendoset në shkëmbinj të e moshave të ndryshme në sistemin e çarjeve dhe midis gëlqerorëve.

Në shfaqjen e Kërçishtit takohet si mineral i rrallë, në gjithë brezin e thyerjes Vlorë – Elbasan – Dibër, dausoniti, që përfaqëson një ndryshim anësor hidrotermal. Dausoniti është formuar nga bashkëveprimi i kripërave alkalinores me mineralizimet alumosilikate. Është provuar që tretësit hidrottermale, që formojnë vendburimet teletermale të arsenikut dhe të zhivës, për nga natyra janë alkalinores me pH të lartë. Formimi i dausonitit ka ndodhur nga bashkëveprimi i karbonatit të natriumit me silikatin aluminor, duke mbetur i lirë SiO₂. Ky është shkak që dausoniti në vendet ku takohet me sasi më të mëdha, si në Koman të Pukës etj., shoqërohet nga kuarci.




Figura 2. Harta formacionale tektonike e rajonit Kërçisht – Qafa e Rosnikut (përpunuar grafiku nga Hoxha et al. 2020).

Në Kërçishtin e Sipërm dhe në gjithë objektet e tjera si ndryshime anësore tipike të këtij tipi janë argjilizimi, kuarcëzimi, karbonatizimi, piritizimi, baritizimi etj. Në objektin e Kërçishtit të Sipërm dhe veçanërisht në objektet e tjera të Korabit (Stanet e Preshit, Varri i Sejmenit, Burimet e Izvirit etj.) disa analiza rezultojnë me përmbajtje të larta të arit, i cili në prova të caktuara arrin 5 – 10 gr/ton, tregues ky me rëndësi për vlerësimin e tyre. Vendburimet e tipit të realgar - auripigmentit me përmbajtje të arit të tipit teletermal të temperaturave të ulëta, njihen në bote si tipi “Carlin i Nevadës të Amerikës”, që aktualisht është tipi kryesor i arit në botë. Vendburimet e këtij tipi janë në rritje dhe në kërkim të vazhdueshëm.

Prandaj duke filluar nga objekti i Kërçishtit të Sipërm e deri në Qafën e Rosnikut, përveç vlerësimit të sqfurit, arsenikut, duhen studiuar dhe vlerësuar edhe për përmbajtjet e arit etj. në drejtime dhe për tipe të ndryshme të lokalizimit të realgar – auripigmentit në shkëmbinjtë coprizorë, ranorë, konglomerate dhe gëlqerorë.

Burimet e magmatizmit të ri që kanë dhënë këto mineralizime janë ende të paqarta, jo vetëm në tërthoren Vlorë – Elbasan – Dibër, por edhe në objektet e tjera të tërthores Shkodër – Pejë, ku mineralizimet janë më të përhapura dhe më të studiuara. Mineralizimet lokalizohen në shkëmbinjtë e Paleogjenit dhe formimi i tyre është më i ri. Më poshtë do të trajtohen shkurtimisht disa nga shfaqjet më kryesore të këtij rajoni, lidhjes midis tyre dhe problemeve të kërkimit e perspektivës.

Objekti Kërçisht i Sipërm – Kllobçisht

Në afërsi të fshatrave Kërçisht i Sipërm dhe Kllobçisht, Bashkia e Dibërs, gjendet i vetmi objekt i sqfurit nativ që njihet deri tani në vendin tonë. Autorë vendas e të huaj kanë studiuar sektorin nga këndvështrime e nivele të ndryshme. Punimet e kryera në vitet 1984 – 1990 (Hoxha

1990), hapën perspektivën jo vetëm për mineralizimin e sqfurit, por dhe për kërkimin e mineralizime të tjera të gjenezës hidrotermale (Hoxha 2001). Në ndërtimin gjeologjik të objektit të mineralizuar të Kërçishtit të Sipërm marrin pjesë formimet e Verfenian – Anizianit ($T_1 - T_2^a$), Titionian – Cenomanianit ($J_3 - Cr_{cm}$), të Kretakut të Sipërm (K_2^s) dhe Eocenit të Mesëm – Oligocenit (?) ($Pg_2 - Pg_3$?). Përhapje të konsiderueshme kanë edhe formimet e sotme të Kuaternarit (Fig. 2). Nuk përjashtohet depërtimi i evaporiteve, të cilat mund të kenë komplikuar situatën gjeologjike, por që nuk janë bërë pengesë për qarkullimin e teletermave në gëlqerorë, flish etj. Punimet e kryera në shtrirje të kompleksit mineralmbajtës, nga Përroi i Kërçishtit e deri në Përruan e Pesokut mbi Klobçisht, kanë vërtetuar vazhdimësinë e mineralizimeve dhe flasin për pritshmëri cilësore e sasiore të tyre (Hoxha 1999a, 2000, 2001).

Mineralizimi i Sqfurit

Fillimisht kjo shfaqje është vlerësuar vetëm si objekt për kërkimin e sqfurit nativ ndaj është dhe më i studiuar. Në pjesën e sipërme të prerjes karbonatike të Santonianit (K_2^s) lokalizohet zona zgavrore kryesore sqfurmbajtëse, midis gëlqerorëve të dolomitizuar që shërbejnë si dysheme, dhe kryesisht dolomiteve në pjesën e sipërme që shërbejnë si tavani (Hoxha 1999a, 2001). Mineralizimet jashtë kësaj zone janë sporadike dhe pa interes praktik. Trashësia e zonës produktive luhatet nga 20 deri 30 m dhe brenda saj përvijëzohen 2 deri 3 nivele sqfur mbajtës. Format e trupave të sqfurit nativ përcaktohen nga forma e hapësirave në zonë. Mbizotërojnë xhepat, foletë, lentet (Fig. 3). Trashësia e trupit xeheror luhatet nga disa centimetra në 2 – 3 metra dhe cilësia nga 2 – 3 % deri në 50 – 51 % S.

Vizualisht dallohen, sqfur kristalin me ngjyrë të verdhë në jeshile, rrallë sqfur i përzier me lëndë sterile gëlqerore e gjipsore, sqfur amorf në

trajtë shtresash me trashësi deri 0,5 m dhe sqfuri pluhuror mes gëlqerorëve të bardhë kristalor. Gjithashtu është takuar edhe sqfuri i zi, blloqet e të cilit janë me mineral amorf me ngjyrë të zezë nga lëndë bituminoze të përzierë me material gjipsi e gëlqerori. Shkëmbinjtë e zonës sqfuri mbajtëse përfaqësohen kryesisht nga gëlqerorë të dolomituar, dolomite, aragonite, gjipse, anhidrite etj. Karbonatet paraqiten kokërmëdhënj deri mesatar, poroz dhe rrallë edhe me imprenjime organike me ngjyrë gri hiri të çelët të mbushur me sqfuri nativ duke marrë pamjen leopardine.

Zona produktive përvijëzohet në shtrirje me gjithë nivelet e saj rreth 700 m dhe në rënie rreth 180 m. Nuk vërehet ndonjë ligjësi në mbushjen e hapësirave me sqfuri si për anën

sasiore dhe atë cilësore. Në shpellat karstike ku mbushja me sqfuri nativ është e pakët vërehet mjaft mirë zhvillimi i stalaktiteve e stalagmiteve.

Elementët hapësinor të shpellave karstike ku kemi lokalizimin e trupave sqfurbajtës, përkohje me shtrirjen dhe rënien e tyre të përgjithshme. Tektonika e pasmineralizimit është pak e zhvilluar. Mineralizimin sqfuri e mendojmë të formuar si rezultat i qarkullimit të tretësirave termale nëpër çarjet, porët dhe kavernat gëlqerore, ku linja tektonike e buzës perëndimore të objektit, pjesa më e mëdha e së cilës është e mbuluar, ka kontrolluar ardhjen e tyre (Fig. 3). Ekzistenca e niveleve të kavernave karbonatike në formimet e Santonianit ka përcaktuar nivelet sqfurbajtëse të formuara më vonë, si rezultat i qarkullimit të tretësirave në fjalë në




Figura 3. Prerje gjeologjike përfaqësuese në objektin e sqfurit Kërçisht i Sipërm në zonën e Maqellarës. Shkalla e lirë (sipas Hoxha 1999a, 2001): 1. Formime të Verfeian-Anizianit ($T_1-T_2^a$), kryesisht mergeloro-gelqerore dhe silicoro-radiolaritike; 2. Formime të Kretakut të Sipërm (K_2^s) kryesisht gëlqerorë të facies së cekët; 3. Formime flishore argjiloro-ranore etj. të Eocen-Oligocenit (?), ($Pg_2^2 - Pg_3$); 4. Flish argjiloro-karbonatik i Titonian-Cenomanianit (J3-Cr2cm); 5. Kontakt tektonik midis formimeve të ($T_1-T_2^a$) nga njera anë dhe formimeve të flishit të Eocen-Oligocenit (?) e atyre karbonatike të Kretës së Sipërme (K_2S) në anën tjetër; 6. Zona të mineralizuara me sqfuri dhe mineralizime të tjera kryesisht sulfure të arsenikut në zonat tektonike dhe ato të kontaktit ndërformacional; 7. Formime të Kuaternarit; 8. Drejtimi i menduar i ardhjes së teletermave; 9. Kontakt tektonik mbihypës i flishit Jurasiko-Kretak mbi atë të Eocen-Oligocenit (?); 10. Kontakt transgresiv.

këto hapësira (Hoxha 1999a). Ecja me punime duhet të bëhet drejt perëndimit, drejt thyerjes tektonike, sepse aty kanë qarkulluar tretësirat dhe aty çarjet e shkëmbinjve priten të jenë më të mëdha e më të mbushura me sqfuri. Si kolektorë më të rinj për grumbullimin e sqfurit, mendojmë prerjen më të re të mbuluar të gëlqerorëve kretak, drejt perëndimit. Kjo prerje është me e panjohur dhe padyshim duhet të ketë porozitet më të madh se ndodhet afër zonës së thyerjes tektonike. Gëlqerorët e Verfenianit e sidomos ranoro – konglomeratet e “Serisë Luma”, si shkëmbinj porozë, pranë thyerjes tektonike duhet të kenë edhe të çara dhe që mund të priten cekët në perëndim të thyerjes.

Mineralizime të tjera

Punimet e kryera pas vitit 1984 vërtetuan praninë e disa mineralizimeve të tjera (Hoxha 1999a, b). Pranë horizonteve zgavrore të mineralizuara me sqfuri nativ në Galerinë nr. 4 (Fig. 3), në pjesën tavanore të tyre janë takuar kristale kubike fluoriti me ngjyrë jeshile të çelur, deri pa ngjyrë. Vizualisht mund të flitet edhe për praninë e halitit, baritit dhe celestit.

Gjatë hapjes së Galerisë nr. 8, e cila ka ndërprerë zonën më cilësore të mineralizimeve sulfureve të arsenikut të takuara deri më sot në këtë objekt (Fig. 3), në një bllok gëlqerori të Santonianit, veç mineralizimeve të realgar –auripigmentit, është takuar edhe dausonit, me ngjyrë të bardhë, me ndërtim radialo-rrezor, i cili së bashku me mineralizimet e tjera mbush të çarat. Gjithashtu si produkte të proceseve të prishjes së sulfureve të arsenikut konstatohet mineralizimi i skoroditit, anabergitit dhe simplezitit me ngjyra dominuese të gjelbër të hapur.

Galeria nr. 14 ka vërtetuar praninë e mineralizimeve sulfure të arsenikut edhe në kontaktin trasgresiv të flishit Eocen – Oligocen (?) me Gëlqerorët e Santonianit (Fig. 3). Në disa punime

sipërfaqësore janë takuar evaporite ku janë vrojtuar të tre grupet e minera–leve përbërës. Në kontaktin e flishit Eocenik me gëlqerorët e Santonianit, ku përgjithësisht vërehet një horizont argjilash me ngjyrë të zezë, gri në të kaltër (Ndojaj 1958) është veçuar me analiza kimike prania e vanadit dhe selenit. Gjithashtu në fillimin e prerjes së gëlqerorëve të Santonianit janë takuar mineralizime sulfure të zinkut. Mineralizimi i arsenikut i përfaqësuar nga realgari dhe auripigmenti është ndër me të përhapurit pas sqfurit, në objektin në fjalë (Hoxha 1999a). Mineralizimi kryesor në këtë objekt janë sulfuret e Arsenikut i cili është takuar edhe në gëlqerorët e Santonianit, por jo në atë sasi si në flishin e Eocenit – Oligocenit (?) dhe bllokun jo rrënjësor të gjetur në formimet e shpatit pranë Galerisë nr. 8 që cilësuam më sipër. Punimet e kërkimit të kryera në rënie kanë vërtetuar këto mineralizime, me një rritje të komponentëve nga ana cilësore e sasiore. Për vlerësimin e tyre më në thellësi paraqesin interes jo vetëm mineralizimi i sqfurit e arsenikut, por edhe mineralizimet e tjera më të çmueshme si ato të arit etj. Drejt thellësisë, pra drejt perëndimit ose drejt Fushës së Maqellarës, perspektiva është e hapur. Ne mendojmë se mineralizimet në fjalë janë të lidhura me veprimtarinë hidrotermale të një magmatizmi të ri pascenik i lidhur me thyerjet tektonike, të cilat kanë kontrolluar gjithë mineralizimet e tjera që ndeshen në rajon.

Prania e arsenikut, fluoritit, dausonit na shtynë drejt analogjisë së këtyre mineralizimeve me ato që takohen në kontaktin e Zonës Tektonike të Cukalit me zonat e tjera, si në Koman, Brazhde (Dukagjin etj.). Në tërësi, drejtimet e kërkimit të mineralizimeve në këtë objekt, duhen parë të lidhura me magmatizmin e ri pas Eocenik - Oligocenik (?) jo vetëm këtu por në të gjitha zonat ku dokumentohen shfaqje të kësaj natyre me origjinë hidrotermale (teletermale).

Mineralizimet e Peshkopisë dhe Kasriotit

Në një largësi prej rreth 17 km nga objekti Këçisht i Sipërm – Kllobçisht, na shfaqen mineralizimet e sulfureve të arsenikut duke filluar nga Përroi i Banjave e deri ne Karrierën e gjipsit të Vrenjtit (Hoxha 1999a, b).

Shfaqja e Banjave

Në krahun e djathtë të Përroit të Banjave të Peshkopisë, fare pranë daljes së burimeve të kaptazuara të ujërave termale, në kontaktin e evaporiteve me flishin e Eocen – Oliococnit (?) (Fig. 4), janë takuar min-

eralizime të sulfureve të arsenikut si realgari dhe auripigmenti që vrojtohen vizualisht në trajtë pikëzimesh të rralla deri fole të vogla. Këtu nuk janë kryer punime. Në ndryshim nga mineralizimet sulfure të arsenikut të takuara në Galerinë nr. 8 në objektin e Këçishtit të Sipërm, këtu ai shfaqet pranë kontaktit evaporite – flish, por, deri tani vetëm në flish janë vrojtuar pikëzime të mineralizimeve sulfure. Disa metra larg shfaqjes kemi burime sulfhidrike të ftohta me debit të bollshëm.




Figura 4. Prerja në shkallë të lirë në shfaqjen e mineralizuar të Banjave (sipas Hoxha 2001): 1. Evaporite të Permian-Triasikut të Poshtëm të Njësisë së Dibrës; 2. Formime flishore të Eocen-Oliococnit (?); 3. Kontakt i diapireve evaporitik; 4. Zona ku janë takuar pikëzime të sulfureve të arsenikut jepet e qarkuar me rreth dhe mineralizimet pasqyrohen me ngjyrë të kuqe dhe të verdhë; 5. Drejtimi i menduar i ardhjes së teletermave; 6. Formime të deluvioneve dhe proluvionale.

Shfaqja e Bahutajve

Ndodhet rreth 250 m në verilindje të fshatit Bahutë, në përruan me të njëjtin emër. Mineralizimi vrojtohet me vështirësi midis formacioneve, në trajtë pikëzimesh të imta dhe lokalizohet në krahun e majtë të rrjedhjes së përroit, aty ku ai del nga evaporitet, në kontaktin e tyre me flishin e Eocen-Oliococnit (?). Mund të konsiderohet një pikë e mineralizuar me përmasa të vogla por me rëndësinë e vazhdimësisë së mineral-

izimit. Ai përfaqësohet nga sulfure të arsenikut, kryesisht nga realgari dhe auripigmenti, me ngjyrat karakteristike portokalli dhe të verdhë. Prerja e shfaqjes së Bahutajve është në të njëjtin pozicion gjeologjik me atë të Përroit të Banjave. Nuk janë kryer punime vlerësuese.

Shfaqja e Vrenjtit

Në vitin 2013, gjatë hapjes së karrierës së Vrenjtit për shfrytëzimin e evaporiteve, në kontaktin diapirik me

flishin Jurasiko – Kretak dhe atë të Eocen – Oligocenit (?), janë vrtuar mineralizime sulfure në trajtë pikëzimesh të imta. Duke qenë se aty përplaseshin po thuaj të tre formacionet (Fig. 5) me vështirësi kuptohet situata gjeologjike. Eocen – Oligocenit (?), është i mbuluar tektonikisht nga flishi më i hershëm, por në shtrirjen e zonës shfaqen qartësisht marrëdhëniet

tektonike mbihypëse. Mineralizimi përfaqësohet nga sulfuret e arsenikut ku takohet kryesisht auripigmenti. Pikëzimet e realgarit shquhen me lupë me shumë vështirësi. Edhe kjo shfaqje mund të konsiderohet një pikë e mineralizuar me përmasa të vogla por me rëndësinë e vazhdimësisë së mineralizimit.




Figura 5. Prerje në shkallë të lirë në shfaqjen e mineralizuar të Vrenjtit (sipas Hoxha 2001): 1. Evaporite të Permian - Triasikut të Poshtëm të Njësisë së Dibrës; 2. Formime të flishit Jurasiko – Kretak, me përberje argjiloro – mergelore; 3. Kontakt tektonik mbihypës; 4. Zona ku janë takuar pikëzime të sulfureve të arsenikut jepet e qarkuar me rreth; 5. Formime flishore të Eocen - Oligocenit (?); 6. Formime deluvionale; 7. Drejtimi i menduar i ardhjes së teletermave; 8. Kontakt i diapireve evaporitik.

Mineralizimet e Sillovës

Në këtë zonë shfaqen mineralizimet hidrotermale, me një shtrirje të konsiderueshme, duke filluar nga Trojaku, në Dipjakë e deri në Malësinë e Gramës ku takohet shfaqja e Varrit të Sejmenit (Fig. 1).

Shfaqja e Dipjakës

Kjo shfaqje (Fig. 6) përfaqësohet me dy dalje të emërtuara si zona lindore me rreth 200 m gjatësi dhe rreth 45 m gjerësi, si dhe ajo veriperëndimore, me gjatësi rreth 80 m dhe gjerësi rreth 30 m. Paraqiten me ndërtim tektonik dhe strukturor të komplikuar. Në këto shfaqje janë kryer ndër vite punime kërkuese e vlerësuese. Lokalizimi i mineralizimit në këtë objekt (Fig. 6) është men-

duar në mënyra të ndryshe. Në ndryshim nga studiuesit e mëparshëm (Premti 1971), mendohet se rrafshet tektonike, qofshin ato midis flishit Jurasiko – Kretak dhe atij të Eocen – Oligocenit (?) apo midis këtij të fundit dhe evaporiteve, janë zonat ku duhet të pritet mineralizimi (Hoxha & Alliu 1979; Hoxha 2001; Hoxha et al. 2014). Mendohet se mineralizimi i sulfureve të arsenikut lidhet kryesisht me pakon e Jurasikut të Sipërm – Kretakut të Poshtëm të përfaqësuar nga shiste argjilo – alevrolitike e mergelore, ranorë me ngjyrë gri të errët si dhe serpentinitet e përfshira nga tektonika gjatë branisjeve të fuqishme. Mineralizimi takohet në zona të dobësuar, pranë rrafshit të mbihypjes së flishit Jurasiko – Kretak mbi

Shfaqja e Trojakut

Ndodhet në jug të fshatit Trojak në përruan e Topuzit (Fig. 7). Ndërtohet nga gëlqerorë të kuq radiolaritikë, pllakore me bivalvie pelagjike të rrallë. Sipër tyre, vendosen gëlqerorë biomikritike me krinoide të imët e të vegjël, me ngjyrë hiri të bardhë të kristalizuara e të përshkruara nga kalciti diagjenetik. Gëlqerorët, në sipërfaqe, paraqiten të shkatërruara dhe me pamje brekçioze, për shkak të çarjeve të shumta që i përshkojnë në të cilat takohet mineralizimi i arsenikut dhe vizualisht vërehet prania e realgar – auripigmentit. Nga një pus i hapur rezulton se mineralizimi rritet në sasi e cilësi drejt thellësisë. Situ-

ata gjeologjike është e trazuar për faktin se mineralizimi vendoset afër kontaktit tektonik mbihypës të formimeve paleozoike mbi fliшет në fjalë. Përgjatë përroit vërehet me lehtësi një zonë oksidimi e cila është takuar përgjithësisht në disa shfaqje të tilla, ku sundojnë ngjyrat e kuqerremta, të verdha dhe gri. Mendohet se mineralizimi duhet të lidhet më teletermat që kanë shfrytëzuar si rrugë kalimi rrafshet tektonike mbihypese deri mbulesore, në rastin tonë rrafshin e bransjes së formacioneve paleozoike mbi fliشين Jurasiko – Kretak dhe këtij të fundit mbi fliشين e Eocen – Oligocenit (?) paraqesin interes për t'u kërkuar më tej (Hoxha et al. 2014).




Figura 7. Prerje gjeologjike në shfaqjen e mineralizuar Trojak (sipas Hoxha 2001): 1. Formime paleozoike të pandara; 2. Gëlqerorë të kuq radiolaritik, gëlqerorë biomikritik të rikristalizuara; 3. Linjë tektonike; 4. Zonë e mineralizuar me sulfure të arsenikut; 5. Pus mineraler i cekët i cili ka takuar mineralizim sulfuresh të arsenikut; 6. Formime flishore argjilo – ranore.

Shfaqja e Varrit të Sejmenit

Ndodhet në një situatë të ndërlikuar tektonike, e atakuar nga diapirizmi i gipseve që ka sjellë nga thellësia fragmente të shkëmbinjve të moshave të ndryshme. Këtu takohen evaporitet, depozitimet fliшoidale të J_3^t - Cr_2^{cen} , serpentinite, gëlqerorë masive, rreshe argjilore deri alevrolite,

grafit - sericitikë me kokrriza e damarë kuarci si dhe depozitimet fliшoidale të Eocen – Oligocenit (?) (Fig. 8).

Mineralizimi i arsenikut takohet në shkëmbinjte e moshave të ndryshme, por kryesisht në gëlqerorët e fliشit Jurasiko – Kretak në trajtë cipash, njollash, damarësh, pikëzimesh, pa ndonjë rregullsi të dukshme dhe

igmenti të cilët gjenden në formë pikëzimesh, cipash e damarësh në boshllëqet e shkëmbit. Në kokrriza të imëta e më radhë në trajtë grumbullimesh e damarësh takohet markaziti. Punimet e mëvonshme (Kodra et al. 1986; Hoxha et al. 2007; Hoxha et al. 2009; Hoxha et al. 2011; Hoxha et al. 2014), tregojnë se shfaqja në fjalë nuk duhet parë si një shfaqje arseniku, por më në kompleks.

Kështu, tërheqin vëmendjen, ndonëse shumë të rralla, përmbajtjet e ngritura të Au nga 5.6 – 11.59 gr/ton dhe të Sb deri 0.06 %, Sn deri 0.006 % (në një rast deri 0.21 %), Mo deri 0.0006 %. Nuk përjashtohet prania e Be e Ba që nuk janë analizuar dhe fakti i pranisë së Hg në provat e metalometrisë. E gjithë kjo bashkësi elementësh flet për praninë e mineralizimeve hidrotermale të temper-

aturave të ulëta me interes praktik, ku spikat arseniku si indikator i fuqishëm i këtyre vendburimeve.

Gjithashtu, vlen të theksohet se punimet minerare të kryera me vonë (Hoxha et al. 2012; Hoxha et al. 2014), kanë takuar në thellësi zonën e mineralizuar, vizualisht të përfaqësuar nga realgari, auripigmenti, piriti dhe më rrallë pikëzime të imta kalkopiriti, ku analizat kimike të kryera japin: As deri 10.17 %, Au deri 1.04 gr/ton, Fe_2O_3 deri 18 %, MnO deri 0.5 %, Cu etj. Punimet tematike të kryera më vonë nga kanë rezultuar me disa të dhëna premtuese për Au, ku spikat prova me 2.62 gr/ton. Provat janë marrë në sipërfaqen e zonës sheherore (Hoxha et al. 2014).




Figura 9. Prerje gjeologjike në shfaqjen e mineralizuar Stanet e Preshit (Hoxha 2001): 1. Formime evaporitike të P-T₁ të Njesisë së Dibrës; 2. Formime rreshpore argjiloro - klorit - sericitike, argjiloro - sericitike, alevrolito - kuarcore, silico - mikrokristaline, karbonatike të T₁-T₂; 3. Formime flishoidale të Eocen - Oligocenit (?); 4. Shkëmbinj me ngjyrë kafe, të ndryshuar në kontakt me gjipset; 5. Kontakt tektonik mbihypës; 6. Zonë e mineralizuar me sulfuret e arsenikut; 7. Formime elu - deluvionale; 8. Drejtimi i menduar i ardhjes së teletermave; 9. Kontakt i diapireve evaporitike.

Shfaqja e Qafës së Rritheve

Ndodhet 500 m në perëndim të Staneve të Preshit, të menduar nga ana jonë si vazhdim i saj, edhe pse formacionet rrënjësore janë të maskuara nga depozitimet e reja kryesisht morenore.

Mineralizimi lokalizohet në kontaktin e gipseve me shkëmbinj të tjerë të përfaqësuar nga rreshpe argjilo-

silicore-kuarcore, kryesisht të Triasikut të Poshtëm të Mesëm por dhe të Eocen - Oligocenit (?). Rezultatet e punimeve të kryera flasin për praninë e mineralizimeve sulfure të As dhe Cu, oksideve të Fe-Mn etj.

Shfaqja Burimet e Izvirit

Kjo shfaqje e mineralizuar ndodhet aty ku na shfaqet i zhveshur rrafshi i mbihypjes së depozitimeve të Ordo-

Shfaqja e Kepit të Stogjit

Ndodhet rreth 350 m në lindje të Shpellasit dhe ndiqet në shtrirje për rreth 70 m. Paraqet një linxë argjilo-silicore me mineralizim hekur - manganorë në formë njollash, cipash deri

dhe xhepa, të lokalizuar midis gëlqerorëve të formacionit të Korabit (T_2 - T_3 ; Fig. 11), ku MnO në disa raste arrin 36.9 % dhe Fe = 12.3 %. Edhe këtu, veç mineralizimit hekur-manganor, takohet Cu, As, Pb, Ga, Ni, Co etj.




Figura 11. Prerje gjeologjike në shfaqjen e mineralizuar Kepi i Stogjit në shkallë të lirë (sipas Kodra et al. 1986 dhe Hoxha 2001): 1. Gëlqerorë shtresë mesëm deri shtresë trashë; 2. Zonë minerale; 3. Reshpe silicore - radiolaritike.

Shfaqja e Shpellasit

Ndodhet në lindje të objektit Buri-met e Izvirit. Paraqet një linxë rreshpesh argjilo-silicore radiolaritike me ngjyra laramane, me mineralizim hekur -manganorë në formë njollash, cipash deri dhe xhepa, me një trashësi zone rreth 2 m, të lokalizuar midis gëlqerorëve të formacionit të Korabit të T_2 - T_3 (Fig. 12). Ajo ç’ka i jep

rëndësi kësaj shfaqjeje janë jo vetëm përqëndrimet e mëdha në disa raste të mineralizimeve të hekur – manganit ($MnO = 44.98\%$ dhe $Fe_2O_3 = 42.3\%$), por prania e Cu, Pb, Zn, As_3 , etj. Ky bashkëshoqërim elementarë tregon natyrën hidrotermale të shfaqjes dhe paraqet perspektivë drejt thellësisë.




Figura 12. Prerje gjeologjike në shfaqjen e mineralizuar Shpellasi në shkallë të lirë (sipas Kodra et al. 1986 dhe Hoxha 2001): 1. Zonë e mineralizuar; 2. Rreshpe argjilo – silicore – radiolaritike, rrallë karbonatike.

Shfaqja e mineralizuar Stani i Ali Jakupit

Në regjimin hidrologjik të ujit paddyshim që ndikojnë shumë përbërja gjeologo – litologjike e pellgut ujëmbledhës, prania në pjesën me te madhe e shkëmbinjve të papërshkushëm, mbulesa bimore jo shumë e pasur, karakteri jo shumë i lartë e i coptuar i relievit, gjatësia e përrenjve që derdhen në të etj. Gjatësia e lumit nga Ura e Rrogozhinës ne grykëderdhje rrezulton: në vitin 1970 në 38 km, në vitin 1980 në 40.5 km ndërsa aktualisht ai është më i shkurtër. Gjerësia e lumit varion nga 100 në 250 m. Thellësia e lumit arrin rreth 2.5 – 3 m, ndërsa në grykëderdhje edhe më tepër. Në Rrogozhinë prurja mesatare shumëvjeçare e rregjistruar 59.9 m³/s. Prurjet maksimale prej 810 m³/s janë rregjistruar në nëntor të viti 1962. Prurja mesatare vjetore llogaritet 50 – 60 m³/s.

NDËRTIMI GJEOLOGJIK

Pellgu i Shkumbinit nga ana gje-

ologjike ndërtohet nga shkëmbinj të moshave të ndryshme kryesisht ultrabazike, të cilët shtrihen në të dy anët e Shkumbinit. Lugina ndërtohet prej ranorëve dhe konglomeratëve, ndërsa pjesa qëndrore prej shkëmbinjve karbonatike. Ndërsa pjesa e poshtme që i përket zonës në studim, është pjesë e Ultësirës Pranadriatike, e cila është themeluar në fillimisht në Sevaralian dhe Tortonian, pastaj zhytet në pjesën lindore dhe zihet nga deti, ku janë formuar facie të cekta ranoro – argjilore me gëlqerore litotamnikë. Në perëndim ka vazhduar akumulimi suksesiv, por në fund të Miocenit (Mesinian) këtu janë depozituar edhe facie lagunore evaporitike. Në fund të Miocenit, Ultësira Pranadriatike rrudhoset lehtë e del mbi ujë. Më vonë gjatë Pliocenit, ajo zhytet në pjesën perëndimore dhe zihet nga deti, ku dhe janë depozituar molasat me përbërje konglomeratike dhe ranoro – argjilore. Një rrudhosje e fuqishme kapi ultësirën në kufirin Pliocen – Kuaternar sidomos në perëndim dhe ka rezultuar në ngritjen e saj mbi ujë, dhe formimi i vargjeve antiklinale dhe sinklinale, të cilët japin formë e relievit i sotëm kodrinor. Këto struktura përfaqsohen kryesisht nga depozitime të Pliocenit dhe të Kuaternarit të vonshëm të përbëra nga shkëmbinj të rrënjësorë argjilo – alevrolitorë, ranorë e konglomeratë (Fig. 2).

Depozitimet e Pliocenit (N₂)

Këto kanë përhapje sipërfaqësore në pjesën lindore të rajonit dhe janë të përfaqsuara litologjikisht nga dy litofacie të emërtuara formacioni Helmesi dhe Rrogozhina.

Formacioni Helmasi takohet në sipërfaqe në strukturat kodrinore në jug, veri e lindje, ndërsa në shpatet e kodrave dhe në zonen e ulët fushore ato mbuloohen nga depozitimet e formacionit Rrogozhina. Ato shtrihen mbi depozitimet Mesiniane herë herë me transgresion. Ato janë të përfaqsuara nga argjila masive, të hirta e me nuanca të kaltërta dhe arrijne trash-

METODOLOGJIA

Për të arritur te rezultatet e këtij punimi është përdorur interpretimi i të dhenave nga punime të kryera më parë për qëllime të ndryshme, metoda fushore dhe laboratorike nëpërmjet:

1. Interpretimit i të dhenave të mbledhura nga punime të kryera më parë në zonë.
2. Puna në terren për të vëzhguar zonën, ndryshimet e ndodhura në deltën e lumit Shkumbin nga ndryshimi i grykëderdhjes, si dhe gjendja e pjesëve të abandonura nga shtrati i vjetër.
3. Grumbullimi i kampioneve të dheut në prerjet nga kanale e gropa të hapura në pika të ndryshme në të dy anët e lumit për të analizuar treguesit kryesorë fizikë dhe klasifikimin e këtyre dherave për qëllime ndërtimi.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Sipas parashikimeve izostatike të bëra nga Lambeck & Johnston (1995) niveli relativ i detit përgjatë vijës bregore të Adriatikut ka qenë 3 – 4 m nën nivelin aktual rreth 6000 vjet më parë, dhe 1 – 1,5 m nën nivelin aktual 2000 vjet më parë. Është e mundur, pra, që gjeomorfologjia e sotme bregdetare e Adriatikut të sigurojë një rekord të ndryshimeve bregdetare që shtrihet të paktën deri në 6000 vitet e fundit. Dhjetë mijë vjet më parë, kur shtrirja e akullnajave Weichselian e cila preku shumë Evropën veriore dhe Amerikën e Veriut, ka qenë në maksimum, niveli i detit arriti rreth 120 m nën nivelin e sotëm (Fairbanks 1989).

Kështu Lumenjtë që sillnin sediment nga brendësia do të kalonin në një fushë bregdetare deri në rreth 100 km të gjerë përpara se të arrinin në det shumë më larg në perëndim se vija bregdetare e tanishme. Gjatë pjesës së fundit të Pleistocenit dhe

Holocenit të hershëm, niveli i detit u rrit me shpejtësi, shkalla u rrit ndoshta në rreth 20 – 30 mm/vit. Kjo ishte një periudhë e një trasgresioni të madh kur vija bregdetare kishte migruar me shpejtësi në drejtim të lindjes përgjatë fushës. Shperndarja përgjatë vijës bregdetare e sedimentit ranor të sjelle në bregdet nga ujërat e lumenjve të kohës ka të ngjarë të jetë bërë gjithnjë e më i kufizuar, për mjediset e depozitimeve të plazheve apo deltaike kalimtare, të shkatërruara nga trasgresioni.

Depozitimet deltaike, deltaiko – detare dhe detare janë të ndërthurura në mënyrë komplekse në fushën deltaike të lumit Shkumbin, ashtu si në ato të Semanit dhe Vjosës. Për interpretimin e llojeve të sedimenteve Kuaternare, ato të Holocenit që gjenden në gropat dhe punimet e bëra brenda fushës deltaike janë mjediset e depozitimit brenda të cilave sedimenti ka ardhur apo është formuar në vend. Pothuajse të gjitha dherat që gjenden në thellësi ose që mbulojnë sipërfaqen janë formuar në kushte të ngjashme me depozitimet deltaike aktuale në frontin e deltës, por tipet e mjedisëve të depozitimit dhe e llojet e depozitimeve që lidhen me to varen nga zhvillimi gjeologjik i rajonit. Depozitimet e fushës deltaike aktuale janë rezultat i depozitimeve në drejtim të detit nga deltat në kohë të ndryshme gjeologjike dhe deltat aktuale e lumit Shkumbin. Sa herë që lumi Shkumbin ka shtrirë deltat e tij drejt detit (Fig. 4), ai ka braktisur një rrjedhë tepër të zgjatur në favor të një rruge më të shkurtër dhe më të drejtpërdrejtë për në det. Kronologjia e zhvendosjeve më të fundit të deltës shihet edhe në imazhet e google të 20 viteve të fundit. Grykëderdhja e lumit në periudha të ndryshme ka ndërruar pozicionin disa herë, ku deri në vitin 1960, grykëderdhja e lumit gjendej në veri të Divjakës në vendin e quajtur Kular. Grykëderdhja ndante rrethin e Lushnjës me atë të Durrësit (sot rrethi i Kavajës). Pas viteve 1960, grykëderdhja e lumit është spostuar rreth 1.7 km në drejtim të Lushnjës.

Nga pika ku lumi ka krijuar shtratin i ri (Vilë Bashtovë) deri në grykëderdhje gjatësia e lumit ka qënë rreth 5.5 km. Nga investigimi në vend vërehet se lumi tenton të ndryshojë përsëri shtratin e tij.

Degët e shtratit të vjeter të lumit, kanë pjesërisht ujë por jo në të gjithë gjatësinë. Katër mjedise kryesore sedimentimi janë ndërthurur në

mënyrë komplekse në formimin e depozitimeve deltaike: (a) sedimentet aluviale janë depozituar kryesisht në zonat e brendshme, në një rrip të ngushtë përgjatë rrjedhës; (b) depozitimet aluviale – detare shtrihen në grykat e deltave në ujërat e ëmbla deri në të kripura; (c) depozitimet organike formohen in situ ose barten në distanca të shkurtra dhe ridepozitohen në mjedisin lagunor,




Figura 4.

Hartë skematike të lëvizjeve të shtratit të lumit Shkumbin (sipas Lulit & Boçit 1966; e modifikuar sipas imazheve nga Google Earth).

dhe (d) erozioni dhe depozitimi nga deti rezulton në ato sedimente të lidhura vetëm në mjedisin detar. Këto depozitime përfaqsohen nga argjila, suargjila, rëra e zhavorre në gjendje të shkrifët. Trashësia e depozitimeve të Kuarternarit në fushën deltaike arin mesatarisht deri në 30 – 40 m. Materiali sedimentar i sjellë nga lumi në pjesën e poshtme të rrjedhës deri në grykëderdhje formon forma të ndryshme relievi si fusha deltaike, duna, breza rërore, bare etj. Në zonën e meandrave të lumit Shkumbin sedimentohen rëra dhe rëra zhavorrore të shtratit të lumit. Zhavorret sedimentohen zakonisht në shtratit e lumit ndërsa rëra në anët e tij (Fig. 4). Studimi i meandrave të sotme të lumit mund të çojë në prognozimin dhe lokalizimin e meandrave të vjetra në jug apo veri të tij në varësi të kohës gjeologjike. Përsa i përket aktivitetit gërryes të erozionit dhe sedimentues, pra mbushës të lumit, rezulton se aktiviteti sedimentues është disa herë më i lartë se ai eroziv gjë që ka ndikuar në ndryshimin e herëpashershëm të shtratit të lumit dhe formimin e deltës së tij ndoshta në pozicione të ndryshme në jug dhe në veri të deltës së sotme.

Ndërsa në jug kjo dukuri ka krijuar kushtet për ndarjen nga deti të

gjirit të dikurshem jugor të deltës së atëhershme dhe formimin e lagunës së Karavastasë e të plazhit të Divjakës, në veri ajo ka krijuar kushtet për përurimin e plazhit të bukur të Spillesë me një brez të gjatë rëror.

Laguna e Karavastasë ndodhet në jug të grykëderdhjes aktuale të lumit të Shkumbinit dhe ndahet nga deti nëpërmjet një rripi të ngushtë tokë e cila mund të përfaqësojë një deltë të vjetër të lumit. Ndërsa sot mund të vërehet pa vështirësi argjilizimi i pjesës veriore të plazhit të Divjakës (Mesonjesi 2003). Brezat dhe zonat rërore ndodhen në veri të grykëderdhjes së lumit deri në fshatin Spille e më tej me një shtrirje rreth dhjetë kilometra. Grumbullimi i një materiali kaq të shumtë mund të sillej nga një lumë i tillë siç është Shkumbini, prandaj përforcohet ideja më sipër që në këtë drejtim mund të ketë qënë një grykëderdhje e vjetër (Mesonjesi 2003). Në segmentin nga Ura e Rrogzhinës deri në grykëderdhje, në të dy anët e lumit, në kanalet e gropat e hapura janë takuar depozitime në gjendje të pakonsoliduar me veçorite të përshkruara si më poshtë (Fig. 5), ndërsa për kampionet e marrë janë kryer analizat për të përcaktuar treguesit e tyre fizikë.

Prerja	Trashësia	Përshkrimi	
Prerja 1	0-40 cm	Argjilë pluhurore depozitime të reja, me ngjyrë gri, vazhdojnë deri në 40 cm.	Prerja 1 nuk ka horizonte të diferencuar, por është ndërtuar në forme shtresash si rezultat i prurjeve të lumit, pozicionohet 400 m në jug - perendim të Urës së Rrogozhinës, brenda argjinaturës.
	40-85 cm	Përzierje suargjila me plasticitet mesatar + surërë me ngjyrë kafe e çelur.	
	85 -160 cm	Rrëtit prezenca e rërës bëhet kalimi nga suargjila në rëra gjatë prerjes.	
Prerja 2	0-30 cm	Argjilë pluhurore depozitime të reja, ngjyre kafe e çelur, deri në 60 cm.	Prerja 2 nuk ka horizonte të diferencuar qartë, vendodhja në Çermë e Sipërme.
	60-90 cm	Përzierje suargjila+ surërë me njolla gri.	
	90 -170 cm	Rrëtit prezenca e rërës bëhet kalimi nga suargjila në rëra të bardha gjatë prerjes.	
Prerja 3	0-60 cm	Argjilë pluhurore depozitime të reja me ngjyre kafe e çelur, deri në 60 cm.	Prerja 3 nuk ka horizonte të diferencuar, vendodhja në Çermë e Poshtme, 600 -700 m larg lumi.
	60-90 cm	Kalimi në suargjila rritet prezenca e rërës.	
	90 -160 cm	Përzierje Suargjila - Surëra me nuaca të verdha	
Prerja 4	0-20 cm	Tokë e mbulluar me bimësi, gri e errët e përshkueshme nga rrënjët.	Prerja 4 ndodhet rreth 1.5 km nga bregdeti në Pyllin e Vërrisë.
	20-120 cm	Kalimi gradual në surëra rritet prezenca e rërës.	
	120cm - vijim	Shtresë rëre	
Prerja 5	0-25 cm	Tokë e mbulluar me bimësi e hinjtë e erret, bëhet kalimi gradual në surëra.	Prerja 5 ndodhet rreth 500 - 600 m nga vija bregore në krahun e Kavajës.
	25-45 cm	Rërë me kokriza kafe.	
	45 cm vijim	Shtrese rëre.	
Prerja 6	0-70 cm	Argjilë pluhurore depozitime të reja me ngjyrë kafe e çelur me nuanca të kuqe.	Prerja 6 nuk ka horizonte të diferencuar qartë; vendodhja në Kalaja e Bashtoves (Kavajë).
	70-95 cm	Përzierje suargjila+ surërë me ngjyrë të çelur.	
	95 -160 cm	Rrëtit prezenca e rërës , kalohet nga suargjila në surëra njolla të bardha në gri.	
Prerja 7	0-65 cm	Argjilë pluhurore depozitime të reja me ngjyrë të hirtë te erret tderi në 65 cm.	Prerja 7 nuk ka horizonte të diferencuar qartë; vendodhja në Kalush.
	65-125 cm	Përzierje suargjila+ surërë me ngjyrë të çelur.	
	125-160 cm	Përzierje suargjila+ surërë rritet permbajtja e rërës.	
Prerja 8	0-60 cm	Argjilë pluhurore, depozitime të reja me ngjyre kafe të errët.	Prerja 8 është e pa diferencuar me horizonte; vendodhja në Rrogozhinë në largesinë 500 - 600 m larg lumit.
	60-95 cm	Suargjila me nuancë me ngjyrë tulle të çelur.	
	95 -160 cm	Suargjila rritet përmbajtja e pluhurorëve dhe rërës.	

Figura 5. Prerjet dhe vecoritë e depozitimeve të studiar.

Nga të dhënat e prerjeve dhe në bazë të analizave laboratorike për kampionet e marrë rezultojnë se depozitimiet i përkasin dy grupeve të dherave: dhera me kohezion përfaqësuar nga argjilat dhe suargjilat, si dhe dhera pa kohezion përfaqësuar nga rërat dhe surërat. Nga rezultatet e analizës së plasticitetit paraqitur në grafikun e plasticitet tregojnë dherat me kohezion i përkasin argjilave dhe pluhurorëve me plasticitet të ulët por edhe ato me plasticitetet të lartë ku sipas sistemit të klasifikimit USCS i përkasin grupit CH, CL, CL – ML, MH dhe ML (Fig. 6). Dhera të tilla nëse nuk identifkohen dhe llogariten saktë

parametrat projektues mund të krijojnë problematika gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të objekteve inxhinierike.

Rezultatet e analizave granulometrike paraqitur në kurbën granulometrike (Fig. 7) sipas grafikut të propozuar nga Tsuchida & Hayashi (1972) tregojnë që këto dhera paraqesin potencial lëngëzimi gjatë godtjeve sizmike, pasi kurbat granulometrike pothuajse për të gjithë kampionët e analizuar ndodhen brenda zonës me potencial të lartë lëngëzimi. Dherat pa kohezion referuar përbërjes granulometrike sipas sistemit të klasifi-

kimit USCS i përkasin grupeve SW, SM, SP-SM, SC-SM, kryesisht rëra të mirësorjuara dhe pluhurore, që ne

pergjithesi konsiderohen bazamente të mira, por problematikë kryesore kanë lëngëzimin.




Figura 6. Grafiku i plasticitetit për dherat me kohezion në zonën e studimit.




Figura 7. Grafiku për pritshmërinë e rërave për lëngëzim (sipas Tsuchida & Hayashi 1972).

PËRFUNDIME

Në këtë punim bazuar në karakteristikat litologjike të depozitimeve Pliocen – Kuaternar jepet një mendim mbi modelet sedimentuese në mjedisin deltaik të lumit Shkumbin. Katër mjedise kryesore sedimentimi janë ndërthurur në mënyrë komplekse në formimin e depozitimeve deltaike:

- Sedimentet aluviale janë depozituar kryesisht në zonat e brendshme.
- Depozitimet aluviale – detare shtrihen në grykat e deltave në ujërat e ëmbla deri në të kripura.
- Depozitimet organike formohen in situ ose barten në distanca të shkurtra dhe ridepozitohen në mjedisin lagunor.
- Erozioni dhe depozitimi nga deti rezultojnë në ato sedimente të lidhura vetëm në mjedisin detar.

Analiza e përgjithshme mbi depozitimet deltaike që paraqitet në këtë punim tregon se deltat janë më komplekse sesa janë konsideruar më parë, deltat e krijuara janë në dinamikë të vazhdueshme dhe ndryshojnë konfiguracionin si rezultat i ndryshimit të pozicionit të grykederdhjes së lumit. Gjithashtu mund të shërbejë si ide për studime të mëtejshme në mbrojtjen e plazhit nga argjilizimi, depozitim të materialit argjilor mbi atë rëror si pasojë e ndryshimit të modelit të sedimentimit të materialit që sjell lumi i devijuar nga migrimi i deltave nëpërmjet ndërtimeve inxhinierike. Po kështu, edhe në ndërtimin e masave mbrojtëse për mbrojtjen nga erozioni, disiplinimin e rrjedhave dhe mundësinë e devijimit të grykederdhjeve nëse mund të jetë e nevojshme. Në bazë të analizave të kryera, mund të identifikohen shtresat e dheut që mund të shkaktojnë probleme dhe sipas sistemit të klasifikimit USCS, ato përfshihen në grupet CH-CL, CL-ML, MH-ML si dhe SP, SM, SP-SM, SC-SM.

REFERENCAT

- COLEMAN N. L. (1981).** VELOCITY PROFILES WITH SUSPENDED ON THE OPEN-CHANNEL DISTRIBUTION. *WATER RESOURCES RESEARCH*, 22 :10, 1377-1384.
- FAIRBANKS R.G. (1989).** A 17 000 – YEAR GLACIO-EUSTATIC SEA LEVEL RECORD: INFLUENCE OF GLACIAL MELTING RATES ON THE YOUNGER DRYAS EVENT AND DEEP OCEAN CIRCULATION. *NATURE*, 342, 637-642.
- LAMBECK K. & JOHNSTON P. (1995).** LAND SUBSIDENCE AND SEALEVEL CHANGE: CONTRIBUTIONS FROM THE MELTING OF THE LAST GREAT ICE SHEETS AND THE ISOSTATIC ADJUSTMENT OF THE EARTH. IN: BARENS F.B.J.; BROUWER F.J.J. AND SCHRODER, F.H. (EDS.): LAND SUBSIDENCE - *PROCEEDINGS OF THE 5TH INTERNATIONAL SYMPOSIUM ON LAND SUBSIDENCE. BALKEMA, ROTTERDAM*, 3-18.
- MËSONJËSI A. (2003).** DEPOZITIMET ALUVIALE TE DELTES SE SHKUMBINIT. *REVISTA NAFTA SHQIPTARE*, Nr. 2.
- RAKIPI N., BONJAKU S. & JANO K. (2005).** STUDIMI KOMPLEKS I TEKTONIKËS, SEDIMENTIMIT DHE ZONAVE HIDROKARBURMBAJTËSE NË ULTËSIRËN PRANADRIATIKE, DUKE PËRFSHIRË DHE ATO DETARE SI DHE BASHKELIDHJA E DEPOZITIMEVE DETARE E KONTINENTALE TE PLIOCENIT TE SIPERM E KUATERNARIT. *FONDI AKBN, FIER*.
- TSUCHIDA H. & HAYASHI S. (1972).** ESTIMATION OF LIQUEFACTION POTENCIAL OF SANDY SOILS. *MCGRAW HILL INC.: NEW YORK, NY, USA*.
- WRIGHT L.D. & COLEMAN J.M. (1973).** VARIATIONS IN MORPHOLOGY OF MAJOR RIVER DELTAS AS FUNCTIONS OF OCEAN WAVE AND RIVER DISCHARGE REGIMES. *AMERICAN ASSOCIATION OF PETROLEUM GEOLOGISTS BULLETIN*, 57, 370-398.

OVERVIEW OF THE SHKUMBIN RIVER DELTAIC DEPOSITS

MAJLINDA MEÇAJ (SINA)^{1*}

¹Polytechnic University of Tirana, Faculty of Geology and Mining, Rruga e Elbasanit, Tirana, Albania

*Corresponding author: majlinda.mecaj@fgjm.edu.al

(Manuscript submitted in July 2024; accepted for publication in November 2024)

ABSTRACT

This paper gives generalized information on the Shkumbin River deltaic deposits in the flat area, where the river flows from east to west. This paper aims to consolidate the data collected from various geological works in the area, attempting to specify deltaic depositional environments. Attention is focused on those deposits which, due to their weak physical properties, are the most important from the engineering point of view, since it becomes necessary that these later depositions can be used as basements for construction, due to the development of tourism in this area and the whole region. If their design parameters are not identified and calculated correctly, such soils can cause problems during the construction and use of engineering facilities. The general analysis of deltaic deposits presented in this paper shows that deltas are more complex than previously considered, the created deltas are in continuous dynamics and change their configuration due to the change in the position of the river estuary.

Keywords: depositions, deltaic, river estuary, Shkumbin River.

INTRODUCTION

Deltas are deposited landforms that are created in rivers downstream. Their evolution is mainly controlled by river flows, the type and amount of sediment supply, regional and global sea levels, and changes in wave energy. The morphology and

sedimentary sequences of deltas depend on the relative magnitude of tides, waves, and currents (Wright & Coleman 1973). Deltaic deposits can be divided into three sedimentary facies (in ascending order; Fig. 1): prodelta, delta front and deltaic plain (Coleman 1981).



Figure 1. Image of Shkumbin river delta, sedimentary facies according to Coleman (1981; Image from Google earth).

The Shkumbin River Delta ranks third in size on the southern Adriatic coast, after the Vjosa and Semani rivers' deltas. Its plain surface covers several km², while the submerged area (pro – delta) extends over approximately 1.5 km² on the continental shelf. The plain surface has a coastline of about 5 km long, being a plain that reaches a maximum height of 4 – 5 m above sea level. The area is bordered to the west by the Adriatic Sea, to the south by the Divjaka hills, to the East by the Lushnje – Rogozhina highway, and to the North by the Ballaj Kryevidhi hills. The deltaic plain includes the largest area of deltaic deposits used initially only for agriculture, but for economic, and tourism development recently, in this region, the geological – engineering study of these later depositions is necessary to be used as foundations for construction. A wide network of chanals that serve to drain surface waters and preserve agricultural lands are crossing the deltaic plain.

The water hydrological regime is greatly influenced by the geological – lithological composition of the catchment basin, the existence of mostly impermeable rocks, the lack of plant cover, the low relief and fragmented character of it, the length of the flowing streams, etc. The length of the river from the Rogozhina Bridge to the estuary was 38 km in 1970, and 40.5 km in 1980, while currently it is shorter. The width of the river varies from 100 m – 250 m. The river depth is 2.5 – 3 m, while in the river estuary, it is even more. In Rogozhina, the average long – term flow recorded was 59.9 m³/s. The maximum flows of 810 m³/s were recorded in November 1962. The average annual flow is calculated at 50 – 60 m³/s.

GEOLOGICAL SETTING

Geologically, the Shkumbin basin is built from rocks of different ages, mostly ultrabasic, which lie on both sides of Shkumbin. The valley is made of sandstones and conglomerates,

while the central part is represented by carbonatic rocks. While the lower part that belongs to the study area, is part of the Peridriatic Depression, which was established initially in the Sevaralian and Tortonian, then sinks in the eastern part and it's washed by the sea, where shallow sandy – clay facies with lithotomic limestone are formed. The successive accumulation continued in the west, but at the end of the Miocene (Messinian), it was deposited also a gypsum lagoonal facies. At the end of the Miocene, the Peridriatic Depression is slightly folded and emerged above the water. Later during the Pliocene, it sinks in the western part and is covered by the sea, where conglomeratic and sandy – clay molasse deposits were accumulated. A powerful folding captured the lowlands at the Pliocene – Quaternary boundary, especially in the west, and moved it above water, where the anticlinal and synclinal units were formed, representing today's hilly relief. These structures are mainly represented by Pliocene and late Quaternary deposits composed of clay-siltstone, sandstone, and conglomerate bedrock (Fig. 2).

The depositions of the Pliocene (N₂)

These deposits are spread at the surface in the eastern part of the region and are lithologically represented by two lithofacies units, named Helmesi and Rogozhina formations.

Helmesi Formation outcrops in the hilly ranges in the south, north, and east, on the slopes of the hills, and in the low plain area they are underlaid by the deposits of the Rogozhina formation. They overlay transgressively the Messinian sediments. They are represented by massive grey – bluish clays, reaching a thickness of about 1000 m. In the upper part of the section, the existing siltstones and sandstones become more frequent and pass gradually into the Rogozhina Formation.

The Rogozhina Formation extends

on the slopes of the hills and the plain which is overlaid by Quaternary deposits. The lower part is represented by a mixing of conglomerates, gray – yellowish sandstones, rare fine-grained claystone. The upper part is represented by conglomerates and sandstones intercalations. The thickness of these deposits is different, and they reach up to 1200 m.

Quaternary depositions (Q)

These deposits extend over the anticline and syncline structures of the

Periadriatic Depression. The Quaternary deposits that cover the plain part of the depression are represented by marine sediments of Pleistocene age, marine – lacustrine and continental sediments of Holocene age (Rakipi et al. 2005). According to the Quaternary base map (Fig. 3), the Quaternary deposits in the central part of the deltaic plain are 30 – 40 m thick on average, but in certain sectors increase up to 200 m.



Figure 2. Geological map of the area (according to the map scale 1:100 000).




Figure 3. Scheme of the depth of the Quaternary deposits (according to Rakipi et al. 2005).

METHODOLOGY

For this paper, the interpretation of data from previously performed works for different purposes, field and laboratory methods was used through:

1. Interpretation of data collected from works previously carried out in the area.
2. Field work to investigate the area, the changes that occurred in the Shkumbin River delta due to the change of the river estuary, as well as the condition of the of the river old beds.
3. Collection of soil samples in cuttings from channels and open pits at different points on both sides of the river to analyze the main physical properties and classify these soils for construction purposes.

RESULTS AND DISCUSSION

According to the isostatic predictions made by Lambeck & Johnston (1995) the relative sea level along the Adriatic coastline was 3 – 4 m below the current level, approximately 6000 years ago, and 1 – 1.5 m below the current level around 2000 years ago. It is possible that the present day coastal geomorphology of the Adriatic provides a record of coastal change that stretches back at least over the last 6,000 years. Ten thousand years ago, at the maximum extent of the Weichselian glaciation, which affected the northern Europe and North America regions, the sea level reached about 120 m below today's level (Fairbanks 1989).

Thus rivers were bringing sediment from the internal part and would cross the coastal plain up to about 100 km wide before reaching the sea, much further west than the present coastline. During the latest Pleistocene and early Holocene, the sea level rose rapidly, the rate possibly increasing to about 20 – 30 mm/yr.

This was a period of extensive transgression when the coastline migrated rapidly eastwards across the plain. The distribution along the coastline of the sandy sediment brought to the coast by the river waters has probably become more and more limited, for the beach environments or transitional deltaic deposits, destroyed by the transgression.

Deltaic, deltaic – marine, and marine deposits are complexly intermixed in the deltaic plain of the Shkumbin River as well as in those of Seman and Vjosa rivers. For the interpretation of the genetic types of Quaternary sediments, those of Holocene age found in the depths and channels within the deltaic plain are the depositional environments within which the sediment came or was formed in situ. Almost all soils found at depth or covering the surface were formed under conditions similar to current deltaic deposits at the delta front, but the types of depositional environments and the types of deposits associated with them depend on the geological development of the region. The deposits of the present deltaic plain are the result of seaward deposits from deltas at different geological times and the present delta of the Shkumbin River. Each time the Shkumbin River has extended its delta towards the sea (Fig. 4), it has abandoned a long riverbed in favor of a shorter and more direct route to the sea. The chronology of the most recent displacements of the delta can also be seen in Google images of the last 20 years.

The river estuary in different periods has changed its position several times, when until 1960, the river estuary was located north of Divjaka in a place called Kular. The river estuary separated the district of Lushnja from that of Durrës (today the district of Kavaja). After the 1960's, the estuary of the river was moved about 1.7 km towards Lushnja. From the point where the river created a new bed (Vilë Bashtovë) to the river

estuary, the length of the was about 5.5 km. From the field investigation, it is observed that the river tends to change its bed again. The channels of the river's old beds have water in part but not on the whole length.

Four main sedimentation environments are complexly mixed in the formation of deltaic deposits: (a) alluvial sediments are deposited mainly

in the narrow strip along the course; (b) alluvial – marine deposits extend to the mouths of deltas in the waters of fresh to saline; (c) organic deposits form in situ or are transported short distances and redeposited in the lagoonal environment, and (d) erosion and deposition from the sea results in those sediments related only in the marine environment. These deposits are represented by clay, silt,




Figure 4. Schematic map of the Shkumbin riverbed movements (According to Luli & Boçit 1966; modified according to images from Google Earth).

sand, and gravel in a loose state. The thickness of the Quaternary deposits in the deltaic plain reaches on average up to 30 – 40m. The sedimentary material brought from the river in the lower part of the flow to the river estuary forms different landforms such as deltaic plains, dunes, sand belts, bars, etc. In the area of the Shkumbin river meanders, the sand and gravelly sand of the bed and riverbank are deposited. Gravel is usually deposited inside the riverbed, while sand is deposited on its sides (Fig. 4). The study of today's river meanders of the river can lead to the propagation and localization of old meanders to the south or north of it depending on geological time. Regarding the erosive, and depositional activity of the river, it turns out that the depositional activity is several times higher than the erosive one, which has influenced the occasional change of the riverbed and the formation of its delta, possibly in different positions in the south and north of today's delta.

While in the south this phenomenon has created the conditions for the separation from the sea of the for-

mer southern bay of the then delta and the formation of the lagoon of Karavasta and the Divjaka beach, in the north it has created the conditions for the accumulating a sandy belt which represents the beautiful beach of Spille. The Karavasta Lagoon is located south of the current Shkumbin River estuary and is separated from the sea by a narrow strip, so that it is possible to represent an old river delta. Today one can easily observe the siltation of the northern part of the beach of Divjaka (Mësonjësi 2003). Sandy belts and areas are located north of the river estuary up to the village of Spille with an extension of about ten kilometers. The accumulation of such a large amount of material could be brought from such a river as Shkumbin, therefore the above idea, that there may be an old bed in this direction (Mësonjësi 2003). From the Rogozhina Bridge to the river estuary segment, on both sides of the river in the channels and open pits, unconsolidated soils were found with the features described in the tables below (Fig. 5), while the samples taken were analyzed to determine their physical properties.

Cutting 1	Thickness	Description	Soil cutting 1 it does not have differentiated horizons, but it was built in the form of layers as a result of the river flows, it is 400 m south-west of the Rrogozhina Bridge, inside the embankment.
	0-40 cm	Later deposits of silty clay, gray in color to dark brown, continue up to 40 cm.	
	40-85 cm	The mixture of clay with medium plasticity is light brown in color.	
	85 -160 cm	The presence of sand increases and the transition from silt-clay to sand occurs	
Cutting 2	Thickness	Description	Soil cutting 2 , there are no differentiated horizons; the location is in Çerma e Sipërme.
	0-30 cm	Later deposits of silty clay, light brown in color, continue up to 60 cm.	
	60-90 cm	The mixture of clay +sandy silt with spot gray in color.	
	90 -170 cm	The presence of sand increases and the transition from silt-clay to sand	
Cutting 3	Thickness	Description	Soil cutting 3 - there are no differentiated horizons; the site in Çerma e Poshtme
	0-60 cm	Later deposits of silty clay, light brown in color, continue up to 60 cm.	
	60-90 cm	The transition to silty and increase the presence of sand.	
	90 -160 cm	The mixture of clay +sandy silt with spot yellow in color.	
Cutting 4	Thickness	Description	Soil cutting 4 is located about 1.5 km from the coast in Vërria Forest.
	0-20 cm	Vegetated soil, dark gray permeable by roots.	
	20-120 cm	The transition to sandy silt and increase the presence of sand.	
	120cm cont.	Sands layer.	
Cutting 5	Thickness	Description	Soil cutting 5 is located about 500 - 600 m from the coastline on the side of Kavaja.
	0-25 cm	Vegetated soil, dark ash in color, gradual transition to sands.	
	25-45 cm	Sands with spot brown in color.	
	45 cm cont.	Sands layer.	
Cutting 6	Thickness	Description	Soil cutting 6 , there are no differentiated horizons, the location Kalaja e Bashtoves (Kavajë).
	0-70 cm	Later deposits of silty clay, light brown, with spot red in color.	
	70-95 cm	The mixture of clay +sandy silt, light in color.	
	95 -160 cm	The presence of sand increases, from clay to silty sand, with white to gray	
Cutting 7	Thickness	Description	Soil cutting 7 - there are no differentiated horizons; the location is in Kalush.
	0-65 cm	Later deposits of silty clay, dark grey in color, continue up to 65 cm.	
	65-125 cm	The mixture of clay +sandy silt, light in color.	
	125-160 cm	The mixture of clay +sandy silt, increase the presence sand.	
Cutting 8	Thickness	Description	Soil cutting 8 - there are no differentiated horizons; the site in Rrogozhine 500 - 600 m to river.
	0-60 cm	Later deposits of silty clay, dark brown in color,	
	60-95 cm	Silty clay, light brown in color.	
	95 -160 cm	Silty clay, increase the presence of silt and sand.	

Figure 5. Soil cutting and their characteristics.

Based on the description of analyzed cuttings and the samples laboratory analysis, the soils were separated into two groups: cohesive soils (fine – grained soils) represented by clays and clays, and less – cohesive soils (course – grained soils) represented by sands and silty sands. From the results of the plasticity shown in the plasticity chart, cohesive soils belong to clays and silts with low plasticity but, also those with high plasticity, where according to the USCS classification system they belong to the group CH, CL, CL-ML, MH, and ML (Fig. 6). Such soils, if the design parameters are not identified and calculated correctly, can create problems during the construction and use of engineering facilities.

The results of the granulometric analyses presented in the granulometric curve (Fig. 7) according to the Chart proposed by Tsuchida & Hayashi (1972) show that these soils present a potential for liquefaction during seismic shocks since the granulometric curves for almost all the analyzed samples are located within the zone of high liquefaction potential. Cohesionless soils according to the USCS classification system belong to the SW, SM, SP-SM, and SC-SM groups, mainly well – graded sand and silty sands, which are generally considered good basements. Still, the main problem for sands is liquefaction susceptibility.




Figure 6. Plasticity chart for cohesive soils in the study area.




Figure 7. Sands liquefaction susceptibility chart according to Tsuchida & Hayashi (1972).

CONCLUSIONS

In this paper, based on the lithological characteristics of the Pliocene – Quaternary deposits, an opinion is given on the sedimentary types in the Shkumbin River deltaic environment.

Four main sedimentation environments are complexly mixing in the formation of deltaic deposits:

- Alluvial sediments are deposited mainly in the interior areas.
- Alluvial – marine deposits extend to mouths of deltas in fresh to saline waters, erozioni dhe depozitimi nga deti rezulton në ato sedimente të lidhura vetëm në mjedisin detar.
- Organic deposits are formed in situ or transported over short distances and redeposited in the lagoon environment,
- Erosion and deposition from the sea results in those sediments related to the marine environment.

The overview of deltaic deposits presented in this paper shows that deltas are more complex than previously considered, and their continuous dynamics and change configuration are the result of the river estuary position changing. This paper might serve as an idea for further studies on the protection of the beaches from siltation, deposition of clay material on the sand as a result of the change in the sedimentation model of the material brought by the diverted river from the migration of deltas through engineering constructions. The protective measures against erosion would be the monitoring of flows and the possibility of diverting the river estuary if necessity might arise. Based on the obtained results, soil layers that may cause problems are identified and according to the USCS classification system, they are included in the groups CH-CL, CL-ML, MH-ML as well as SP, SM, SP- SM, SC-SM.

REFERENCE

- COLEMAN N. L. (1981).** VELOCITY PROFILES WITH SUSPENDED ON THE OPEN-CHANNEL DISTRIBUTION. *WATER RESOURCES RESEARCH*, 22 :10, 1377-1384.
- FAIRBANKS R.G. (1989).** A 17 000 – YEAR GLACIO-EUSTATIC SEA LEVEL RECORD: INFLUENCE OF GLACIAL MELTING RATES ON THE YOUNGER DRYAS EVENT AND DEEP OCEAN CIRCULATION. *NATURE*, 342, 637-642.
- LAMBECK K. & JOHNSTON P. (1995).** LAND SUBSIDENCE AND SEALEVEL CHANGE: CONTRIBUTIONS FROM THE MELTING OF THE LAST GREAT ICE SHEETS AND THE ISOSTATIC ADJUSTMENT OF THE EARTH. IN: BARENS F.B.J.; BROUWER F.J.J. AND SCHRODER, F.H. (EDS.): LAND SUBSIDENCE - *PROCEEDINGS OF THE 5TH INTERNATIONAL SYMPOSIUM ON LAND SUBSIDENCE. BALKEMA, ROTTERDAM*, 3-18.
- MËSONJËSI A. (2003).** DEPOZITIMET ALUVIALE TE DELTES SE SHKUMBINIT. *REVISTA NAFTA SHQIPTARE*, Nr. 2.
- RAKIPI N., BONJAKU S. & JANO K. (2005).** STUDIMI KOMPLEKS I TEKTONIKËS, SEDIMENTIMIT DHE ZONAVE HIDRO-KARBURMBAJTËSE NË ULTËSIRËN PRANADRIATIKE, DUKE PËRFSHIRË DHE ATO DETARE SI DHE BASHKELIDHJA E DEPOZITIMEVE DETARE E KONTINENTALE TE PIOCENIT TE SIPERM E KUATERNARIT. *FONDI AKBN, FIER*.
- TSUCHIDA H. & HAYASHI S. (1972).** ESTIMATION OF LIQUEFACTION POTENCIAL OF SANDY SOILS. *MCGRAW HILL INC.: NEW YORK, NY, USA*.
- WRIGHT L.D. & COLEMAN J.M. (1973).** VARIATIONS IN MORPHOLOGY OF MAJOR RIVER DELTAS AS FUNCTIONS OF OCEAN WAVE AND RIVER DISCHARGE REGIMES. *AMERICAN ASSOCIATION OF PETROLEUM GEOLOGISTS BULLETIN*, 57, 370-398.

VLERËSIMI DHE ANALIZIMI I TË DHËNAVE LITOLOGJIKE, PËR QËLLIME TË NDËRTIMIT TË HARTËS GJEOTEKNIKE TË SHQIPËRISË NË SHKALLË 1:200 000

MENTOR LAMAJ¹, YLBER MUÇEKU² & ALBERT AVXHI¹

¹Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Rruga Zef Serembe, Tiranë, Shqipëri

²Instituti i Gjeoshkencave, Don Bosko Nr. 60, Tiranë, Shqipëri

*Autor korrespondent: mentorlamaj2@gmail.com

(Dorëshkrim i dorëzuar në shkurt 2024; i pranuar për botim në nëntor 2024)

ABSTRAKT

Gjatë një periudhë tre vjeçare (2019 – 2021) Shërbimi Gjeologjik Shqiptar në bashkëpunim me Institutin e Gjeoshkencave, realizuan Projektin për ndërtimin e Hartës Gjeoteknike të Shqipërisë në shkallë 1:200 000. Një nga të rejat që solli kjo hartë ishte zonimi sipërfaqësor në fushëpërhapjen e formacioneve shkëmbore, si dhe zonimi sipërfaqësor dhe në vertikalisht në fushëpërhapjen e dherave të Kuaternarit, sipas kufijve gjeologjikë që përmban Harta Gjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1:200 000. Përsa i përket shkëmbinjve, zonimi është kryer në tre nivele duke marrë si kriter: 1) rezistencën në shtypjen njëboshtore; 2) coptueshmërinë e masivëve shkëmborë, dhe 3) tipin litologjik. Whereas, as far as soils are concerned, their surface zoning is done entirely according to Eurocode VII standards, while vertical zoning is done using depth contours from the surface of the bedrock ceiling.

Fjalë kyçe: Harta Gjeoteknike, zonim, faktor litologjik, celulë litologjike.

HYRJE

Ndërtimi i Hartës Gjeoteknike të Shqipërisë në shkallë 1:200 000, ka qenë prej vitesh një domosdoshmëri për organet vendimmarrëse të planifikimit të territorit. Kjo hartë shërben si konsultë në fazat e para të projektimit të objekteve inxhinierike. Kjo fazë, në vendet e zhvilluara perëndimore, konsiderohet si faza më e rëndësishme, për arsye se në të gjykohet dhe vendoset për zonën ku do të ndërtohet, duke ballafaquar të dhënat e projektit të ndërtimit me resurset dhe mundësitë e ndryshme dhe të shumta që ofron territori.

Të dhënat bazë të shfrytëzuara për përpilimin e hartës kanë qenë të dhënat ekzistuese në arshivën e SHGJSH-së, si dhe eksperiencat e autorëve të kësaj harte në fushën e studimeve gjeoteknike në territorin e Shqipërisë, sigurisht duke u konsultuar edhe me arritjet kryesore shkencore të vendeve europiane. Pas viteve 2000, Shërbimi Gjeologjik

Shqiptar ndërmori një seri studimesh të karakterit tematik ku më i rëndësishmi ishte ndërtimi hartave shumë qëllimore. Në kuadër të këtij projekti, i cili vazhdon dhe në ditët e sotme, është arritur të mbulohet pothuaj i gjithë territori i Shqipërisë në bazë të planshetave në shkallë 1:25 000, për shumë elemente, por në mënyrë të veçantë për gjeologjinë, rrezikun gjeologjik, gjeologjinë inxhinierike, hidrogjeologjinë, të cilat mbartin një informacion të detajuar (sipas shkallës), dhe që përbën një bazë të rëndësishme për ndërtimin e hartave të tjera tematike në shkallë më të vogla.

Po ashtu në fushën e gjeologjisë inxhinierike janë kryer studime të veçanta për rajonizimin gjeologjik – inxhinierik të disa zonave të mëdha urbane si Durrësi, Gjirokastra, Berati, Kruja etj. Zhvillimi intensiv i infrastrukturës rrugore në Shqipëri, si dhe veprave të ndryshme inxhinierike, ka dhënë informacion të konsiderueshëm sa i përket parametrave

gjeoteknikë të shkëmbinjve dhe dherave për zona të veçanta. Po ashtu, bazuar në të dhëna të reja të marra nga këto lloj studimesh, është arritur që të përpilohen dhe të botohen hartat: Harta gjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1: 200 000 (2002), Harta e Gjeorrezikut e Shqipërisë, në shkallë 1:200 000 (2005), Harta Gjeologjike – Inxhinierike e Shqipërisë, në shkallë 1:200 000 (2014), Harta e Inventarit e Rrëshqitjeve në Shkallë 1:200 000 (2015); Harta e Ndjeshmërisë ndaj Rrëshqitjeve në territorin e Shqipërisë, në shkallë 1:200 000 (viti 2015) dhe Harta Hidrogjeologjike e Shqipërisë, në shkallë 1:200 000 (viti 2017). I gjithë informacioni i marrë nga këto studime krijoi një bazë shumë të rëndësishme për përpilimin e Hartës Gjeoteknike të Shqipërisë në shkallë 1:200 000, e cila tashmë është një hartë e kompletuar me të dhënat e fundit, e cila plotëson më së miri kondicionet bashkëkohore që kërkohen për këto lloj hartash.

Karakteristikat litologjike të territorit të Shqipërisë

Në këtë kapitull jepen mjetet dhe mënyrat e trajtimit të faktorit litologjik për realizimin e zonimit gjeoteknik të trojeve të Albanideve. Është përdorur një metodikë krejt e ndryshme nga ajo e bërë nga tekstet shpjeguese të hartave të tjera të karakterit gjeologjik në shkallë 1:200 000. Stili i deritanishëm përshkruar ka qenë që për çdo pikë të vertikale të moshor, bëhej përshkrimi i fushëpërhapjes dhe litologjisë, pavarësisht zonave apo nënzonave tektonike të Albanideve ku ato ndodheshin. Kurse stili i përdorur në tekstin e Hartës Gjeoteknike konsiston në atë që për çdo pikë në sipërfaqen e territorit të Albanideve, bëhet përshkrimi i kolonës vertikale i të gjitha formacioneve shkëmbore të të gjitha moshave gjeologjike. Për ti ardhur në ndihmë këtij lloj përshkrimi u ndërta një tabelë me tre pjesë përbërëse të saj: 1) stratigrafia, 2) shkëmbinjtë magmatikë dhe 3) dherat e Kuaternarit. Në secilën prej tyre, kolonat

vertikale tregojnë Zonën, Nënzonën, apo Njësinë tektoniko – faciale të Albanideve, kurse në horizontalitet tregohet moshat gjeologjike. Kombinimi i rreshtave (H) dhe kolonave (V) formojnë “celula” të përfaqësuar nga një lloj i caktuar litologjik. Pra çdo ndërthurje e ndarjeve vertikale dhe horizontale, formon një “celulë” unike litologjike, të mirë përcaktuar për sa i përket vendndodhjes dhe moshës së saj gjeologjike. Këto “celula” shërbyen në vijim për realizimin e zonimit gjeoteknik të Albanideve.

Zonimi gjeoteknik i Albanideve

Zonimi gjeoteknik i trojeve për të gjithë territorin e Shqipërisë, në shkallë 1:200 000, është realizuar duke marrë për bazë kufijtë gjeologjikë midis llojeve të ndryshme të shkëmbinjve apo dherave, të cilat i përmban Harta Gjeologjike e Shqipërisë në shkallë 1: 200 000. Në Hartën Gjeologjike të Shqipërisë kufijtë midis llojeve të ndryshme shkëmbore janë të disa tipeve: gjeologjik normal, gjeologjik transgresiv dhe tektonik. Pavarësisht nga lloji i tyre, ato janë konsideruar të njëjtë si kufi gjeologjik.

Zonimi është realizuar në katër nivele:

A. Niveli i parë bazohet në llojin e tyre gjenetik dhe i klasifikon trojet në shkëmbinj dhe në dhera.

B. Niveli i dytë bazohet në parametrin më të rëndësishëm mekanik të shkëmbinjve, sikurse është rezistenca në shtypje njëboshtore. Në bazë të këtij parametri i gjithë territori shqiptar ndahet në 5 zona:

I. Zona e shkëmbinjve shumë të fortë

II. Zona e shkëmbinjve të fortë

III. Zona e shkëmbinjve mesatarisht të fortë

IV. Zona e shkëmbinjve të butë

V. Zona e shkëmbinjve shumë të butë

C. Niveli i tretë i zonimit bazohet në parametrin GSI (Geological Strength

Index), i cili është parametër që vlerëson gjendjen aktuale të ndodhjes së shkëmbinjve në natyrë. Ky tregues shpreh shkallën e ndryshimit (dobësimi) të parametereve fiziko – mekanikë të shkëmbinjve, si rezultat i ushtrimit të presioneve të tokës mbi

ta. Më poshtë po paraqesim skemat e pamjeve të formacioneve shkëmbore sipas vlerave të GSI. Shkëmbinj të shumë të fortë klasifikohen vetëm në nënzonën e shkëmbinjve me GSI >80.




Figura 1. Pamje të shkëmbinjve me fortësi të ndryshme.

Shkëmbinj të mesatarisht të fortë, shkëmbinj të butë dhe shkëmbinj të shumë të butë, klasifikohen në 6 nënzona: 1) me GSI 60 – 75; 2) me GSI 45 – 60; 3) me GSI 35 – 45; 4) me GSI 25 – 35; 5) me GSI 15 – 25 dhe 6) me GSI 10 – 15.

D. Niveli i katërt i zonimit merr parasysh të gjithë parametrat e tjerë fiziko mekanikë, të shprehura në emërtimin e llojit petrografik. Çdonjëra prej tyre ka modelin e vet gjeoteknik, i cili është njësi më e vogël e ndarjes së trojeve në modele gjeoteknike.

Më poshtë po japim në mënyrë të detajuar llojet petrografike përbërëse të secilës zonë.

Simbolet gjeoteknike tregojnë:

Numri i parë romak (I, II, III IV dhe V) tregon numrin e zonës në fushë-epërhapjen e shkëmbinjve, bazuar në rezistencën në shtypje njëboshtore. Numri i parë romak (VI) tregon se në sipërfaqe gjenden dhera mbulesorë të Kuaternarit.

Numri i dytë arab (1, 2, 3, 4, 5, ose 6) tregon numrin e nënzonës brenda zonave të mësipërme, bazuar në vlerën e parametrit gjeoteknik GSI.

Numri i tretë arab (1 deri 10) tregon llojin petrografik brenda zonave dhe nënzonave.

Përcaktimi dhe realizimi i niveleve të zonimit gjeoteknik në tabelat Nr. 1, Nr. 2 dhe Nr. 3, bëri të mundur paraqitjen në hartë të tyre me përshkrimet përfaqësuese të tyre, si vijon:

A – SHKËMBINJTË**Grupi I – Shkëmbinj shumë të fortë (Rsh>1000 kg/cm²) (GSI>80) (Në hartë ngjyra violet).**

- I-1-1 – Bazalte
- I-1-2 – Troktolite
- I-1-3 – Monconite
- I-1-4 – Piroksenite
- I-1-5 – Gëlqerorë

Grupi II – Shkëmbinj të fortë (Rsh = 500 – 1000 kg/cm²) (Në hartë ngjyra jeshile).

GSI 60 – 80

- II-1-1 – Gëlqerorë
- II-1-2 – Ranorë me çimentim karbonatik
- II-1-3 – Rreshpe silicore sericitike
- II-1-4 – Silicorë radiolaritikë.

GSI < 60

- II-2-1 – Granite
- II-2-2 – Verlite, Lercolite, Harcburgite (intruzione ultramafike)
- II-2-3 – Andezite
- II-2-4 – Diabaze (Dajka paralele)
- II-2-5 – Plagjiogranite
- II-2-6 – Mikrodiorite
- II-2-7 – Gabro
- II-2-8 – Dunite
- II-2-9 – Lercolite
- II-2-10 – Peridotite

Grupi III – Shkëmbinj mesatarisht të fortë (Rsh 250 – 500 kg/cm²) (Në hartë ngjyra portokalli).

GSI 60 – 75

